



**NDIKIMI I LIGJIT PËR TË DREJTËN
E AUTORIT DHE TË DREJTAT
E PËRAFËRTA NË PUNËN
E GAZETARËVE, FOTOREPORTERËVE
DHE PUNËTORËVE MEDIATIK
PRAKTIKA DHE REKOMANDIME**



**NDIKIMI I LIGJIT PËR TË DREJTËN
E AUTORIT DHE TË DREJTAT E
PËRAFËRTA NË PUNËN E GAZETARËVE,
FOTOREPORTERËVE DHE PUNËTORËVE
MEDIATIK**

PRAKTIKA DHE REKOMANDIME

SHKUP, 2018

IMPRESUM

Për publikuesin:

Johanes D. Rai, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë
Naser Selmani, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

Autorë:

Ivan Breshkovski
Igor Markovski

Koordinimi:

Davor Pashoski, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë
Dragan Sekullovski, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

Përktheu:

Benjamin Arifi

Lekturoi:

Deniz Sulejman

Përgatitje kompjuterike dhe shtyp:

Vinsent Grafika SHPK Shkup

Tirazh:

200 kopje

Publikimi mund të merret pa pagesë në:

<http://www.kas.de/mazedonien/mk/>

<http://znm.org.mk/>

Shënim:

Kjo analizë është përpunuar me mbështetje financiare nga Fondacioni Konrad Adenauer dhe Bashkimi Evropian në kuadër të projektit "Platforma rajonale e Ballkanit Perëndimor për përfaqësimin e lirisë së mediave dhe mbrojtjen e gazetarëve". Qëndrimet në këtë analizë nuk i përfaqësojnë pikëpamjet e donatorit.

PËRMBAJTJA

Hyrja dhe metodologjia.....	5
Historiat i shkurtër i të drejtës së autorit në Evropë.....	7
Burime ndërkombëtare të të drejtës së autorit.....	8
Aplikimi i të drejtës së autorit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) në krahasim me Evropën.....	11
Rregullativa vendase me theks të veçantë të Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta.....	13
Dispozita të rëndësishme nga Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejta të përafërta të Republikës së Maqedonisë (LDADP) që kanë të bëjnë me gazetarët dhe punonjësit mediatik.....	15
Krahasim i ligjit kroat për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta me ligjin e Maqedonisë që ndikon në punën e gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve mediatik.....	21
Praktika e menaxhimit kolektiv me të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta të gazetarëve dhe fotoreporterëve në Kroaci.....	22
Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në mbrojtje të të drejtës së autorit dhe lirisë së shprehjes, lidhur me punën e gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve mediatik.....	25
Domethënia e verdiktit.....	27
Praktika vendore lidhur me mbrojtjen e të drejtës së autorit në punën e mediave, gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve mediatik.....	29
Kodi etik i gazetarëve dhe politikat e Federatës Evropiane të Gazetarëve në mbrojtje të të drejtës së autorit dhe punonjësve mediatik.....	31
Sistemet e arbitrimit dhe vetërregullimit që zbatohen në Maqedoni, si alternativë për zgjidhjen e rasteve në këtë fushë.....	34
Konkluzat dhe rekomandime për mbrojtjen e të drejtës së autorit të gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve mediatik nga Federata Evropiane e Gazetarëve dhe Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve.....	36
Rekomandime nga FNG për të mbrojtur të drejtat autoriale të gazetarëve.....	38

Reformat prioritare të Qeverisë së RM-së, në kontekst të ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.....	40
Rekomandime për përmirësimin e kornizës ligjore me qëllim të mbrojtjes më të madhe të të drejtave autoriale të gazetarëve dhe punonjësve mediatik.....	41
Lista e shkurtesave.....	43

HYRJA DHE METODOLOGJIA

Në këtë analizë, autorët japin një vlerësim për të drejtën e autorit gjatë punës së gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve të tjerë mediatik. Kjo duke përshkruar legjislacionin vendor dhe të huaj, praktikën gjyqësore dhe qëndrimet mbi këtë tematikë nga organizata të ndryshme ndërkombëtare, politike dhe civile.

Avancimi i mbrojtjes së të drejtës së autorit është i rëndësishëm kur bëhet fjalë për respektimin e prodhimeve gazetareske si tekstet, fotografitë, përmbajtjet audiovizuale, kolumnat, intervistat, karikaturat dhe prodhimet e tjera të cilave do t'u garantohej pronësia.

Në Republikën e Maqedonisë ekziston një perceptim i përgjithshëm se ky ligj më së shpeshti nuk respektohet nga të gjithë përfaqësuesit e sektorit mediatik. E kjo gjendje i dëmton autorët e veprave origjinale, ndërsa kopjuesit, me një përpunim të vogël të përmbajtjeve gazetareske, shpesh imponojnë propagandë ose shpërndajnë lajme gjysmë të vërteta dhe gënjeshtër, me çka shkaktohet dëm edhe mbi autorin por edhe mbi publikun.

Kjo analizë i qartëson pjesët e Ligjit të Maqedonisë për Të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të (LTATP)¹ që janë të rëndësishme për punën e gazetarëve dhe punonjësve mediatik, dhe përveç kësaj bën edhe një analizë për rëndësinë e kësaj teme. Kjo analizë merret edhe me praktikën vendore dhe ndërkombëtare të gjykatave si dhe me qëndrimet e organizatave relevante mes të cilave ato të Federatës Evropiane dhe Ndërkombëtare të gazetarëve. Analizohet realizimi kolektiv i të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, dhe kërkohen mënyra për nxitjen e shfrytëzimit legal të përmbajtjeve autoriale dhe lëndëve që lidhen me të drejtat e përafërta.

Në pjesën e parë të vitit 2018, Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë si organ kompetent për Ligjin për Të drejtat e autorit, hapi proces për ndryshim dhe plotësim të këtij ligji. Sipas Ministrisë së Kulturës, ka nevojë për harmonizim të mëtutjeshëm të këtij ligji me direktivat e 2014/26/BE të Bashkimit Evropian, për menaxhim kolektiv me të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të, si dhe me Direktivën 011/77/BE për ndryshim në Direktivën 2006/116/BE për kohëzgjatjen e të drejtës autoriale dhe të drejtave që lidhen me të, si dhe me Direktivën 28/2012/BE për leje për shfrytëzim të veprave "jetimë" (vepra të cilave nuk u dihet autori, ose nuk mund të kontaktohen). Qëllimi i Ministrisë sipas shpjegimit që e ka bërë

¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër. 115/10, 140/10, 51/11, 147/13, 154/15 dhe 27/16

gjatë propozim ndryshimeve ligjore, që është publikuar në ueb faqen e Regjistrimit të vetëm kombëtar elektronik (ENER), është se duhet *“të krijohen kushte normative për realizim të një sistemi efikas dhe racional të menaxhimit kolektiv me të drejtën e autorit, respektivisht të drejtave të lidhura me të, dhe për nxitje të menaxhimit kolektiv me më shumë lloje të të drejtave”*².

Rekomandimet që do të dalin nga kjo analizë, do t'i dorëzohen Ministrisë së Kulturës si organ kompetent, por edhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Kjo me qëllim të përmirësimit të legjislativit aktual, që është në interes të mbrojtjes më të madhe të punës së gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve mediatik.

Përveç kësaj, kjo analizë është e destinuar edhe për të gjithë pjesëmarrësit e tjerë në sektorin mediatik, ata të sektorit gjyqësor, si dhe për publikun në përgjithësi, me qëllim që të gjithë të informohen për rëndësinë e të drejtës së autorit gjatë prodhimit dhe transmetimit të përmbajtjeve mediatike.

Për përpilimin e këtij punimi, janë konsultuar më shumë publikime të huaja, por janë analizuar edhe akte vendore dhe ndërkombëtare ligjore, si dhe janë analizuar procese vendore gjyqësore. Por është marrë edhe baza e praktikës së Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut që ka të bëjë me shkeljet e të drejtave autoriale. Është konsultuar edhe një numër i madh ekspertësh juridik dhe mediatik, nga vendi dhe jashtë, por edhe gazetarë dhe fotoreporterë të cilët janë të tanguar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga (mos) respektimi i të drejtës së autorit. Në procesin e përpunimit të kësaj analize, kemi marrë mendime edhe nga Ministria e Kulturës, si organ kompetent, nga Këshilli për Etikë në Mediat e Maqedonisë, nga Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë si dhe nga organizata të tjera relevante vendore, nga gazetarë dhe fotoreporterë.

Kjo analizë është e disponueshme edhe në maqedonisht edhe në shqip, dhe e njëjta do tu shpërndahet gazetarëve dhe fotoreporterëve të cilët janë anëtarë të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, por do të mund të shkarkohen falas edhe nga ueb faqja e SHGM-së dhe organizatës Konrad Adenauer. Kjo analizë do të promovohet dhe do jetë e disponueshme edhe në version të shtypur.

² Regjistri i vetëm kombëtar elektronik i rregulloreve https://www.ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_ann_detail&itemid=IEmHh0ymjApDtOnihGC1dw== qasur më 12.07.2018

HISTORIAT I SHKURTËR I TË DREJTËS SË AUTORIT NË EVROPË

E drejta autoriale është përhapur më gjerësisht, nga momenti kur është zbuluar makina e shtypjes, dhe pastaj me shkollimin më masiv të njerëzve. Nga aspekti juridik, prejardhja e të drejtës autoriale në Evropë është nga Britania e Madhe kur në fillim të shekullit të 17, janë paraqitur monopole të shtypshkronjave dhe regjistruar privat të veprave autoriale. Për shkak të shqetësimit nga shtypja e pakontrolluar e librave dhe dokumenteve të tjera të shkruara, Parlamenti Anglez më 1662, ka sjellë Aktin për rregullimin e shtypjes, me të cilin është rregulluar në mënyrë ligjore shtypja dhe distribuimi i këtyre materialeve. Ky akt ka përfshirë edhe krijimin e një regjistri të posaçëm të veprave intelektuale ku janë vendosur kopjet e veprave me çka mbrohej edhe e drejta e autorit. Ky regjistër ka qenë në pronë private të organizatës e cila ka dhënë leje që ndonjë e drejtë e autorit të shtypet dhe të shpërndalet për përdorim më të gjerë. Përveç kësaj, e njëjta kompani ka patur edhe cilësinë e rregullatorit i cili ka dhënë dhe ka marrë leje për shtypje personave të tjerë juridik. Korniza e parë ligjore për të drejtat e autorit, llogaritet Akti për të drejtat e autorit nga viti 1710 (i njohur si Ligji i Ana-s - Statute of Anna) të cilin e solli Parlamenti Britanik.

Ky akt, për herë të parë siguron një mbrojtje juridike të të drejtës së autorit, kësaj radhe e rregulluar nga ana e Britanisë së Madhe dhe gjykatësve, përkundër praktikës nga e kaluara kur kjo çështje ka qenë e rregulluar nga duar private.

Ky akt u siguron botuesve një mbrojtje juridike në kohëzgjatje prej 14 vitesh, dhe pas skadimit të këtij afati, botuesit i kthehen të drejtat përsëri. Akti për të drejtat e autorit nga viti 1710 i ka dhënë fund sistemit të vjetër ku vetëm letërsia e miratuar në bazë të standardeve për censurë të autoriteteve ka mundur të shtypet. Kjo do të thotë se ky akt i jep më shumë liri aktivitetit botues.

Praktikën që të drejtën e autorit ta marrin nën mbrojtje gjykatat kombëtare, tashmë e kanë marrë edhe shtetet e tjera për gjatë viteve, dhe gjithë kjo me qëllim që të krijohet një mbrojtje e përshtatshme e krijuesve të veprave shkencore, letrare dhe artiste.

Për dallim prej praktikave anglosaksone (common law), në Francë, pas revolucionit francez, kuvendi kombëtar ka patur qëndrimin se një botim intelektual për nga natyra është pronë publike, por se të drejtat e autorit bëjnë përjashtim nga ky princip pasi që autori duhet të kompensohet për kontributin e tij.

Në mënyrë shtesë, në vitin 1793 në Francë, është sjellë një ligj sipas të cilit autorëve u jepet e drejta ekskluzive për shitjen dhe distribuimin e veprave të tyre, dhe kjo

e drejtë pastaj do tu kalonte trashëgimtarëve të tyre, deri dhjetë vite pas vdekjes së autorit.

BURIME NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTËS SË AUTORIT

Veprat autoriale në korniza ndërkombëtare, nuk janë të mbrojtura me automatizëm pasi që krijohen, por ekzistojnë marrëveshje ndërkombëtare të cilat ofrojnë mbrojtje për veprat autoriale kur veprat e tilla transmetohen nëpërmjet ndonjë kanali, deri tek publiku më i gjerë.

Një prej konventave më të hershme ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtës së autorit, është **Konventa e Bernit për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike nga viti 1886**³ të cilën Maqedonia e ratifikoi më 8 shtator të vitit 1991.

Konventa ka të bëjë me veprat letrare dhe artistike në të cilat përfshihen edhe filmat, dhe e njëjta kërkon nga shtetet e sajë anëtare që të sigurojnë mbrojtje për çdo krijim letrar, shkencor, apo artistik.

Principi i trajtimit kombëtar nga ana e Konventës ka një rëndësi të veçantë ku thuhet se secili shtet anëtar-nënshkrues i Konventës, do u jep qytetarëve të vendeve të tjera anëtare të drejtat e njëjta autoriale sikurse ua jep qytetarëve të saj.

Konventa e Bernit e obligon secilin shtet anëtar të krijojë korniza minimale ligjore ose “rregulla themelore” në legjislativin vendor të futura në ligj. Një rregull i rëndësishëm i vendosur në Konventë është se periudha prej kur deri kur është i mbrojtur prodhimi i një autori është derisa autori të jetë gjallë, dhe 50 vjet pas vdekjes së tij. Konventa për herë të parë parashikon se mbrojtja e veprave autoriale fillon me vetë krijimin e tyre dhe nuk kërkohet ndonjë regjistrim formal. Në nenin 5, Konventa ndalon që një shtet anëtar, të kërkojë formalitete për regjistrim të ndonjë veprave autoriale. Fokus kryesor i Konventës është më shumë mbrojtja e autorit të ndonjë veprave të caktuar, dhe mbrojtja e të drejtave të tij, më shumë se sa mbrojtja e palëve të cilat transmetojnë veprat në treg, deri tek publiku më i gjerë. Në vitin 1928 me revizionin e Konventës, u imponua koncepti i “të drejtave morale” të autorëve, me çka autorëve u jepet e drejta që të identifikohen tek veprat e tyre.

³ Konventa e Bernit për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike nga viti 1886 http://www.wipo.int/wipolex/en/treaties/text.jsp?file_id=283693, qasur më 07.07.2018

Respektivisht, të theksojnë se ata janë autorët, bartësit e të drejtave autoriale. Autori mund të kërkojë mbrojtje të të drejtave të tij morale, respektivisht që vepra e tij të mos ndryshohet dhe t'i ruhet integriteti, kur ai vlerëson se me një veprim të tillë, do t'i cenohej imazhi, nderi apo ngjashëm.

Dokumenti i dytë ndërkombëtar më me rëndësi është **Konventa Universale për të drejta autoriale (KUDA)**⁴ që është miratuar në Gjenevë, në vitin 1952. Vetë Konventa është krijuar dhe zhvilluar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për arsim, shkencë dhe kulturë (UNESKO) si një alternativë e Konventës së Bernit. Një numër i madh i shteteve, sidomos ato nga “bota e tretë”, e kanë ratifikuar këtë marrëveshje shkaku se kanë vlerësuar se Konventa e Bernit ka qenë vetëm në interes të shteteve të zhvilluara perëndimore, të cilat edhe më së shumti kanë “eksportuar” të drejta autoriale.

Ngjashëm me Konventën e Bernit, parashikohet e drejtë dhe trajtim i njëjtë i autorëve në të gjithë vendet nënshkruese. Kjo nënkupton shkrimin formal tek të gjithë kopjet e veprës me shenjën © si dhe emrin e bartësit të veprave autoriale, dhe vitin e parë të publikimit. Minimumi i kohëzgjatjes së të drejtave autoriale në një vepër është jetëgjatësia e autorit dhe 25 vite shtesë pas vdekjes së tij, përveç për veprat fotografike dhe veprat e artit të aplikuar ku periudha është 10 vite.

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe SHBA-së, e kanë pranuar periudhën prej 70 vitesh pas vdekjes së autorit, si periudhë për mbrojtje të të drejtës autoriale dhe të drejtave morale nga veprat autoriale, dhe kjo është periudhë që zbatohet edhe në Republikën e Maqedonisë.

Është me rëndësi që të theksohet se Konventa nuk i derrogon konventat e tjera multilaterale ose bilaterale, ose aranzhmane mes dy ose më shumë vendeve anëtare. Aty ku ekzistojnë dallime, normat e Konventës Universale për të drejta të autorit duhet të mbisundojnë, përveç në raport me Konventën e Bernit e cila ka prioritet para Konventë Universale për të drejtat e autorit.

Për dallim prej Konventës së Bern-it, **Konventa e Buenos Aires-it**⁵, e nënshkruar më 11 gusht të vitit 1910 nga më shumë shtete të Amerikës Jugore dhe Veriore, mundëson mbrojtjen e të drejtave të autorit nëse përmbajnë fjalën “të drejtat janë të rezervuara” dhe prej këtu vjen edhe thënia e famshme “all rights reserved”.

⁴ Konventa Universale për të drejtën e autorit (KUTA) Gjenevë 1952, http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL_ID=15381&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html qasur më 09.07.2018

⁵ Konventa e Buenos Airesit nga viti 1910, http://www.wipo.int/wipolex/en/other_treaties/text.jsp?file_id=366495 qasur më 09.07.2018

Të gjithë shtetet nënshkruese të kësaj Konvente, tashmë janë të kyçura në Konventën e Bernit, por elementet e saj ende shfrytëzohen si “rregull me afat të shkurtër”, respektivisht, periudha e mbrojtjes së të drejtës së autorit, caktohet në bazë të asaj se në cilin shtet është periudha më e shkurtër (vendi ku është krijuar vepra ose vendi nga i cili kërkohet mbrojtja e veprës)

Një marrëveshje tjetër e rëndësishme multilaterale është edhe **Konventa për themelimin e Organizatës Botërore për pronësi intelektuale**⁶ i ratifikuar nga Republika e Maqedonisë në vitin 1991. Me këtë marrëveshje është themeluar Organizata Botërore për pronësi intelektuale (OBPI). Konventa është ratifikuar në Stokholm më 14 korrik të vitit 1967 dhe numëron gjithsej 191 vende nënshkruese. Qëllimi i kësaj organizate është që të promovojë mbrojtje të pronësisë intelektuale në nivel botëror dhe të sigurojë bashkëpunim administrativ në mes lidhjeve për pronësi intelektuale të themeluara me marrëveshjet të administrohen nga ana e Organizatës Botërore për pronësi intelektuale, e që janë 26 në numër. Vetë ligji për të drejtë të autorit dhe të drejtave të përafërta që janë në fuqi në Maqedoni, por edhe ndryshimet e këtij ligji, janë bërë në bashkëpunim me këtë organizatë.

Marrëveshja për aspektet e tregtisë me të drejtat e autorit (Marrëveshja Trips)⁷ nga viti 1994 në kuadër të Organizatës Botërore të tregtisë që vlen për një prej marrëveshjeve më të rëndësishme që e rregullojnë pronësinë intelektuale, por që merret me të drejtat materiale dhe aspektet tregtare me të drejtat autoriale.

Dokumente të tjera ndërkombëtare që prekin të drejtën e autorit dhe të drejtat nga pronësia intelektuale janë: Deklarata Universale për të drejtat e njeriut nga viti 1948, Pakti ndërkombëtar për të drejta politike dhe qytetare që është ratifikuar nga Republika e Maqedonisë më 18.01 të vitit 1994, Marrëveshja ndërkombëtare për të drejta ekonomike, sociale e kulturore që po ashtu është ratifikuar nga Republika e Maqedonisë më 18.01 të viti 1994, Konventa për distribuim të sinjaleve për transmetim të programeve nëpërmjet satelitëve që është ratifikuar nga Republika e Maqedonisë më 17.11.1991 dhe disa të tjera.

Republika e Maqedonisë ka ratifikuar më shumë marrëveshje ndërkombëtare në këtë temë, dhe si një prej më të rëndësishmeve që tangon punën e gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve mediatik është: Konventa e Romës për mbrojtjen e artistëve që interpretojnë, prodhuesve të fonogrameve, dhe organizatave

⁶ Konventa për themelimin e Organizatës Botërore për pronësi intelektuale nga viti 1967, <http://www.wipo.int/treaties/en/convention/> qasur më 14.07.2018

⁷ Marrëveshja për Aspektet Tregtare të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (kontrata TRIPS) nga viti 1994 https://www.wto.org/English/docs_e/legal_e/27-trips_01_e.htm пристапено на 14.07.2018

radiodifuzive që është ratifikuar nga Republika e Maqedonisë më 02.03.1998. Kjo “marrëveshje” e zgjeron mbrojtjen e të drejtave autoriale prej tek autori i veprës e deri tek krijuesit dhe pronarët e “mediave” të caktuara për transmetim të informatave si kasetat video dhe audio.

Kjo Konventë është krijuar si përgjigje e “teknologjive të reja” siç janë video rekorderët, për dallim prej konventave të mëparshme siç janë Konventa e Bernit e cila më shumë merret me rregullimin e distribuimit të materialit të shkruar. Konventa romake është një lloj i “përgjigjes” ndaj fenomenit të teknologjive të reja ku në mënyrë të thjeshtë, mundësohet që të riprodhohen veprat e interpretuesve, muzicientëve, me të cilën mbrohen të drejtat e “botuesit” të llojeve të tilla të pajisjeve portative (kasetave, disqeve dhe ngjashëm) që përmbajnë vepra autoriale.

Në vitin 2003, Republika e Maqedonisë e ratifikoi marrëveshjen për të drejtën e autorit të Organizatës botërore për pronësi industriale, ndërsa më tej Konventën Evropiane për koproduksion dhe kinematografi, ndërsa përsëri në vitin 2004, Marrëveshjen për interpretim dhe fonograme, në kuadër të Organizatës Botërore për pronësi industriale.

APLIKIMI I TË DREJTËS SË AUTORIT NË SHETETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) NË KRAHASIM ME EVROPËN

Një ekip ekspertësh në krye me profesoreshën Patricija Aufderhajt⁸, profesoreshë për komunikime në Universitetin Amerikan në Uashington, SHBA, kanë bërë një hulumtim për atë se si sfidat e reja që po vijnë me epokën e digjitalizimit, sidomos sfida për punë me material të mbrojtur, ndikon në punën e gazetarëve.

Hulumtimi “E drejta autoriale, liria e shprehjes dhe e drejta që opinioni të mësojë”⁹ është fokusuar në të drejtën e autorit në SHBA. Këtu ekzistojnë shumë paradokse pasi nga njëra anë, ekzistojnë shumë përjashtime ndaj gazetarëve në vijë të përdorimit të veprave autoriale gjatë punës së tyre, ndërsa nga ana tjetër kompanitë komerciale siç janë shtëpitë botuese nga sfera e filmit dhe muzikës, kanë një qasje më strikte kur bëhet fjalë për veprat e tyre. Më tej në këtë analizë

⁸ Biografia e prof. d-r Patricija Aufderhajt, <https://www.american.edu/soc/faculty/paufder.cfm> qasur më 16.07.2018.

⁹ Studimi i prof. d-r Patricija Aufderhajt, https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2119933 qasur më 16.07.2018

shkruan se: “gazetarët ballafaqohen me një hapësirë në të cilën thuajse gjithçka është e mbrojtur me të drejtën e autorit”. Kjo sjellë një pasiguri të rritur mes gazetarëve për përdorimin e saktë të materialit të mbrojtur dhe e vë në pikëpyetje validitetin e rregullit për “përdorim të drejtë” që është tejet i rëndësishëm për punën e gazetarëve në SHBA. Shumica e gazetarëve të intervistuar gjatë studimit, nuk kishin qenë të njoftuar me rregullin e “përdorimit të drejtë” që është pjesë e ligjit amerikan për të drejtë të autorit nga viti 1976. Për shkak të mungesës së informimit të gazetarëve, vuan pjesa më e madhe e punës së tyre.

Në pajtueshmëri me rregullin për “përdorim të drejtë ose fer”, një material i mbrojtur mund të përdoret nëse publiku më i gjere, ka përfitim edukativ nga publikimi i tij, apo kur shërben për debate politike, ose kur promovon zhvillim shoqëror duke përshkruar zbulime të reja ose ngjashëm. Vlera e publikimit të materialeve të tilla të mbrojtura kur vihet në dispozicion të publikut, dhe vlera e sa shoqërore duhet të jetë më e madhe ose e balancuar me humbjen e vlerës (financiare ose materiale) që do ta kishte pësuar pronari i atij materiali nëse publikohet.

Doktrina për përdorim të drejtë e siguron punën e gazetarëve amerikan në një kontekst më të gjerë, pasi ata mund të përdorin materialin e mbrojtur në mënyrë që i mundëson të prodhojnë informata me kualitet të lartë.

Kjo praktikë nuk është rast në shumë shtete të tjera, për shembull në Gjermani dhe në shtetet e tjera evropiane, ku ekziston listë e përjashtimeve për përdorimin e veprave autoriale, nuk ekziston normë në për çdo rast individual, siç ka rregulla për përdorim të drejtë ose fer. Nuk është me rëndësi nëse opinioni ka dobi nga publikimi i materialit ose jo, materiali i mbrojtur nuk mund të përdoret në mënyrë të lirë, nëse nuk përputhet në kategorinë e përjashtimeve.

Nga ky publikim mund të konstatojmë se kur gazetarët kanë mëdyshje, si zakonisht zgjedhin të vetëcensurohen, kështu që nuk e realizojnë misionin e tyre të gazetarit¹⁰.

Federata Evropiane e Gazetarëve bën një analizë të praktikës së Britanisë së Madhe në ditën e sotme. Në doracakun e lëshuar nga kjo organizatë lidhur me gazetarët shkruan se: *“Ekziston një dallim i madh në mes të sistemeve të të drejtave autoriale (Copyright vs. Authors’ rights) dhe ajo ka të bëjë me atë se kush i posedon të drejtat themelore të veprës së krijuar ose prodhuar. Ligji për të drejta të autorit në Britaninë e Madhe për shembull, lejon korporatat që të njihen si autorë. Ndërsa në*

¹⁰ Observatori amerikan për gazetari, autor Karen Gras, publikuar më 28.01.2014, <https://en.ejo.ch/ethics-quality/journalists-copyright-law> qasur më 18.07.2018

të kundërtën e kësaj, të drejtat kontinentale të autorit mund të jenë pronësi vetëm e personave fizik; autorët mund të japin të drejtën e shfrytëzimit të veprave të tyre, por nuk mund ta humbin ndikimin ndaj tyre si krijuesit e konstatuar juridik¹¹

Nga ana tjetër, sipas Akademisë për gazetari në Korporatën Britanike për radiodifuzion, e njohur si “BBC”, ideja për të drejtat e autorit është që të shpërblehen individët (në rastin tonë gazetarët, fotoreporterët, punonjësit mediatik) ose kompanitë (mediat) të cilat krijojnë material dhe i mbrojnë të njëjtit nga kopjimi i paautorizuar i veprave të tyre.

Gjithashtu, pronarit të veprës autoriale i jepet e drejta ekskluzive për të kontrolluar se si do të përdoren këto vepra (kjo e drejtë ekskluzive është rregulluar edhe në Ligjin e Maqedonisë për Të drejta të autorit dhe të drejta të përafërta).

E drejta e autorit shkelet në momentin kur “një pjesë e konsiderueshme” e veprës, përdoret pa leje. “E konsiderueshme” në këtë kontekst, jo çdoherë do të thotë sasia e materialit të përdorur, por se sa është i rëndësishëm ose thelbësor fragmenti që është kopjuar.

RREGULLATIVA VENDASE ME THEKS TË VEÇANTË TE LIGJI PËR TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA

Akti primar me të cilin mbrohet e drejta e autorit është **Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë**, ku në nenin 47, garantohen të drejtat e krijimit shkencor, artist dhe të tjera. Me këtë nen, garantohen të drejtat që burojnë nga krijimi shkencor, artist, ose i ndonjë lloji tjetër intelektual.

Rregullimi ligjor i të drejtës së autorit për herë të parë në Republikën e Maqedonisë për herë të parë është vendosur me hyrjen në fuqi të **Ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtave të përafërta** në vitin 1996. Më parë, në fuqi ka qenë Ligji për të drejtë të autorit në kuadër të RSFJ-së. Më tej, në vitin 2010, ky ligj është shfuqizuar dhe është sjellë ligj i ri me emrin e njëjtë, dhe më pas i njëjti është ndryshuar dhe plotësuar disa herë. (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër. 115/2010, 140/2010, 51/2011, 147/2013, 154/2015 и 27/2016). Në pajtueshmëri me ligjin aktual, rregullohet e drejta e autorëve të mbi veprat e tyre autoriale, pastaj e drejta e artistëve-interpretues,

¹¹ Doracak për të drejtat e autorit, lëshuar nga Federata Evropiane e gazetarëve http://www.ifj.org/file-admin/images/Authors_Rights/Authors_Rights_documents/EFJ_Author_s_Rights_manual.pdf (faq.4)

të prodhuesve të fonogrameve dhe videogrameve, të organizatave radio-televizive, të botuesve dhe krijuesve të bazave të të dhënave mbi lëndët e tyre të drejtave të përafërta si dhe realizimi dhe mbrojtja e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta. Ligji mundohet që të përfshijë konventat ndërkombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare por mbetet edhe në çështjen e asaj se sa ligji zbatohet në mënyrë efikase në praktikë.

Përveç këtij ligji, një ligj tjetër i rëndësishëm i cili e tangon këtë fushë dhe ka një rëndësi tejet të madhe për punën e mediave, e me këtë edhe punën e gazetarëve, është **Ligji për shërbime audio dhe audiovizuale (LSHAV)**¹² sipas të cilit, në nenit 61, në parimet themelore për radiodifuzerët në bazë të të cilave ato kryejnë detyrat, theksohet edhe respektimi i të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta.

Më tej, në **Ligjin për marrëdhënie obliguese**¹³, sipas nenit 9-a i cili ka të bëjë me Mbrojtjen e të drejtave themelore, në bazë të nenit 2 nga ky ligj, si e drejtë personale vlerësohet edhe krijimtaria intelektuale. Kjo do të thotë se secili autor të cilit i janë shkelur të drejtat personale, respektivisht prona intelektuale, ka të drejtë që të kërkojë mbrojtjen e të njëjtëve. Në mënyrë shtesë, neni 619 rregullon marrëveshjen në vepër, për kryerjen e ndonjë pune të caktuar intelektuale, ku porositi obligohet që t'i paguajë kompensim kryerësit të detyrës.

Shkelja e të drejtës autoriale dhe të drejtave të përafërta është e paraparë edhe me **Kodin Penal (KP)** të Republikës së Maqedonisë, me nenin 157, paragrafi 1 i cili thotë se *“ai i cili në emrin e tij ose në emrin e dikujt tjetër në mënyrë të paautorizuar do të publikojë, lëshojë, riprodhojë, distribuojë, interpretojë, emetojë ose në ndonjë mënyrë tjetër do të përdorë të drejtë të huaj autoriale ose të drejtë të përafërt, respektivisht ndonjë veprë të autorit, interpretim ose lëndë të ndonjë të drejte të përafërt, do të dënohet me burg nga gjashtë muaj deri në tre vite”*. Në bazë të këtij neni, janë paraparë edhe dënime që varen nga mënyra me të cilën është e shkelur e drejta autoriale, si edhe lartësia e kompensimit që e ka fituar shkelësi, dhe këto dënime sillen në lartësi prej 6 muajsh deri në 5 vite burg.

Sipas kësaj, ky nen parashikon përndjekje për shkelje të të drejtave morale të autorit, që paraqesin lidhje intelektuale dhe shpirtërore të tij me veprën siç janë: e drejta për të pranuar autorësinë, e drejta për publikim të parë, e drejt për mbrojtje të integritetit të veprës të veprës dhe e drejta për të hequr dorë. Sipas paragrafit 8

¹² “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër. 115/10, 140/10, 51/11, 147/13, 154/15, 27/16

¹³ “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër. 18/01, 4/02, 5/03, 84/08, 81/09, 161/09 dhe 123/13

nga ky nen, përndjekja për shkelje të të drejtës morale të autorit, ndërmerret me propozim të personit të dëmtuar.

Ligji për media¹⁴ i Republikës së Maqedonisë, në fillim të nenit 2, e definon përmbytjen mediatike respektivisht *"...përmbytjet e një mediumi janë të gjithë llojet e informatave (lajme, mendime, njoftime, raporte dhe informata të tjera) si dhe veprat e autorit që publikohen, respektivisht emetohen nëpërmjet një mediumi"*. Në nenin 13 thuhet se përmbytja mediatike e cila ka qenë pre e ndryshimit të konsiderueshëm gjatë redaktimit, nuk mund të publikohet në emër të autorit, pa lejen e tij, në rast se një tekst ose përmbytje e tillë publikohet, atëherë përgjigjet vetë redaktori përgjegjës. Sipas të njëjtit autor, nëse autori vlerëson se me publikimin e një përmbytjeje të tillë do t'i cenohet imazhi, i njëjti ka të drejtë për kompensim të dëmit (shkelje të të drejtave morale të autorit). Në mënyrë shtesë, në ligj është rregulluar edhe obligimi i botuesve tek mediat, që të publikojnë në vend të dukshëm emrin dhe mbiemrin e autorit të secilës përmbytje, respektivisht, emrin e firmës që bart të drejtat autoriale për përmbytjet e publikuara, përveç në mediat e shkruara dhe në radio programet. Ndërkohë në nenin 3 të të njëjtit ligj, garantohet liria e shprehjes dhe liria e mediave, respektivisht garantohet "pavarësia e redaktorit, gazetarit, autorëve dhe krijuesve të përmbytjeve ose bashkëpunëtorëve programor, si dhe personave të tjerë, ndërsa në pajtueshmëri me profesionin..".

Është fakt i pakontestueshëm që e drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta, ndeshen me njëra tjetrën edhe në ligje të tjera siç janë Ligji për Kulturë, Ligji për pronësi Industriale, Ligji për Konkurrencë jolojale, Ligji për Mbrojtje të masave të doganës dhe për mbrojtje të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe të tjera, por në këtë analizë theksohet ajo pjesë e rregullativës e cila më së shumti i tregon gazetarët, fotoreporterët dhe punonjësit mediatik.

DISPOZITA TË RËNDËSISHME NGA LIGJI PËR TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTA TË PËRAFËRTA TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË (LDADP) QË KANË TË BËJNË ME GAZETARËT DHE PUNONJËSIT MEDIATIK

Mbrojtja themelore e gazetarëve në Ligjin për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta është rregulluar në më shumë dispozita ligjore, por për shkak të madhësisë së ligjit, do i kishim ndarë këto:

¹⁴ "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër. 184/13, 13/14

Në LDAP rregullohet e drejta e autorëve mbi veprat e tyre autoriale, e drejta e artistëve-interpretues, e prodhuesve të fonogrameve, e prodhuesve të videogrameve (producent filmik), e organizatave radiotelevizive, e botuesve dhe përpiluesve të bazave për të dhëna të lëndëve të tyre të drejtave të përafërta, e realizimit të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta si dhe vlera e ligjit.

Në nenin 3, është i rregulluar kompensimi material për autorin, respektivisht për bartësin e të drejtës së autorit "...Autori, respektivisht bartësi i të drejtës së përafërt, ka të drejtë për kompensim material për secilin lloj të përdorimit të veprës së autorit, respektivisht veprës së të drejtës së përafërt nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe..."

Në nenin 12 nga Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta, termi e drejtë e autorit është përkufizuar dhe paraqet: "...një vepër individuale dhe intelektuale nga fusha e letërsisë, shkencës dhe artit, e shprehur në çfarëdo mënyre ose formë". Në kontekst të profesionit të gazetarisë, do i kishim theksuar edhe pikën 1, paragrafin 2 nga i njëjti nen ku thuhet se: "... (2) Për vepër të autorit konsiderohet: 1) vepra e shkruar (libri, artikulli, doracak, broshura, diskutim dhe vepra të tjera të së njëjtës natyrë);..." Pika 3: "...vepër gojore (ligjërim, fjalim, tregim ose vepra të tjera të së njëjtës natyrë);. "Pika 6: "...vepra fotografike dhe vepra e krijuar në formë të ngjashme sikurse ajo fotografike;. "Pika 7: "...vepër audiovizuale (vepër kinematografike dhe vepër tjetër e shprehur nëpërmjet fotografive lëvizëse);. "Në mënyrë shtesë, sipas nenit 13 nga Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta "...pjesa përbërëse e veprës së autorit, si dhe titulli i veprës, që vetvetiu paraqet një vepër intelektuale, individuale, llogaritet si vepër e veçantë e autorit"

Si vepër e autorit vlerësohet edhe përmbledhja e veprave të autorit sipas nenit 14 "...siç janë: enciklopedia, analogjia, koleksioni, përmbledhja muzikore, përmbledhja e fotografive, hartat, ekspozita, përmbledhja e dokumenteve dhe përmbledhje të tjera..."

Nga neni 16 ku bëhet një analizë e veprave të pambrojtura që nuk vlerësohen si vepra të autorit, do të kishim vënë theksin tek pika 3 ku thuhet:

"..Si vepër e autorit, në kontekst të këtij ligji, nuk konsiderohen:

- (1) Idetë, teoritë, konceptet, metodologjitë e punës ose konceptet matematikore, pavarësisht mënyrës së shpjegimit ose shprehjes;*
- 2) tekstet e natyrës politike, legjislative, administrative dhe gjyqësore dhe përkthimet e tyre zyrtare;*

3) lajmet ditore dhe të tjerat që kanë karakterin e lajmeve të thjeshta, ose informacioneve të thjeshta mediatike me fakte dhe të dhëna të thjeshta

4) idetë dhe konceptet që paraqesin bazament për cilindo element të programit kompjuterik, përfshirë këtu edhe pjesët e programit që mundësojnë lidhjen dhe interaksionin mes elementeve të pajisjeve programore dhe makinerike (interfejsa)..."

Në nenin 17 nga Ligji për të drejtën e autorit, është theksuar fjala ose domethënia e fjalës autor. Duhet theksuar se autorit i përket e drejta autoriale e veprës me vetë krijimin e veprës, dhe në pajtueshmëri me praktikën e gjykatave të Maqedonisë, nuk kërkohet ndonjë regjistrim formal i veprave autoriale si kusht që ato të gëzojnë mbrojtje duke u bazuar në këtë ligj:

*"..(1) Në kuptim të këtij ligji, Autor llogaritet personi fizik i cili e ka krijuar veprën autoriale.
(2) Autorit i përket e drejta autoriale mbi veprën e tij me vetë krijimin e veprës..."*

Neni 18, paragrafi 1: *"... Presumimi i autorësisë: (1) Autor llogaritet personi, emri, pseudonimi, kodi ose shenja tjetër e të cilit është theksuar në mënyrë të zakonshme tek vepra, si dhe gjatë publikimit, është theksuar tek kopjet, derisa nuk dëshmohet e kundërt, në pajtueshmëri me këtë ligj..."*. Në nenin 19 është theksuar termi për bashkautorë: *"...E drejta autoriale e veprës së krijuar në bashkëpunim me më shumë persona, u përket të gjithë atyre personave (bashkautorëve)"*

Në nenin 20, është rregulluar përmbajtja e veprës së autorit: *"...(1) E drejta e autorit është e drejta e vetme dhe e pandashme nga vepra autoriale (2) E drejta e autorit përmban të drejta ekskluzivë morale, ekskluzive materiale dhe të drejta të tjera që janë të përcaktuara me këtë ligj..."* Në nenin 21, është theksuar termi për të drejtat morale të autorit, dhe të njëjtat e mbrojnë autorin në aspekt të lidhjes së tij personale dhe shpirtërore (intelektuale) me veprën. Autori i posedon këto të drejta ekskluzive morale: 1) të drejtën për njohjen e autorësisë; 2) të drejtën e publikimit të parë; 3) të drejtën e mbrojtjes së integritetit të veprës dhe 4) të drejtën për të hequr dorë.

Në nenin 26 të Ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtave të tjera, janë rregulluar edhe të drejtat materiale të autorit, ku në nenin 2 thuhet: *"Autori ka të drejtën ekskluzive për të lejuar ose ndaluar përdorimin e veprës së tij, ose kopjeve të veprës nga persona të tjerë, përveç në raste të caktuara me këtë ligj"*. Në mënyrë shtesë, në nenin 27 të ligjit, janë theksuar të gjithë të drejtat materiale të autorit gjatë shfrytëzimit të veprës së tij, ose kopjeve të veprës. Në pjesën e tretë, duke filluar nga neni 39 i Ligjit për të drejtën e autorit si "të drejta të tjera" të autorit janë theksuar: 1) e drejta e qasjes dhe kalimit të të drejtave; 2) e drejta për kompensim nga rishitja;

3) e drejta për kompensim gjatë shpërndarjes për përdorim privat; 4) e drejta për kompensim në rast huazimi dhe 5) e drejta për kompensim nga shërbimi.

Në pjesën e 4 të Ligjit për të drejtat e autorit ku janë rregulluar përjashtimet dhe kufizimet në **nenet 51, 52, 53, 54**, janë nënvizuar rastet kur një vepër e autorit nuk mund të përdoret pa lejen e autorit ose pa kompensim material. Nga neni 52 ku është e rregulluar përdorimi i veprës së autorit pa kompensim do i theksojmë pjesët në vazhdim:

- 4) *përdorim i veprave për qëllime ilustrative në hulumtime shkencore, deri në nivel të arsyeshëm, pa qëllime komerciale, por me kusht që të theksohet emri i autorit dhe burimit, vetëm në rast se një gjë e tillë nuk është e mundur;*
- 6) *shumim dhe publikim të shkrimeve, artikujve dhe veprave të ngjashme për tema aktuale nga fusha ekonomike, politike, religjioze dhe ngjashëm, gjithë kjo me qëllim vetëm të informimit të publikut, por deri në nivel të arsyeshëm për të arritur qëllimin. Përveç nëse një gjë e tillë nuk është ndaluar në mënyrë të veçantë nga autori, me kusht që të theksohet autori dhe burimi, përveç nëse një gjë e tillë nuk është e mundur;*
- 7) *përdorimi i pjesëve nga vepra e autorit (citate), për nevoja të hulumtimit shkencor, për ligjërata shkollore, për kritika, polemika ose analiza, në sasi dhe në nivel të nevojshëm për qëllimin e caktuar, por me kusht që të theksohet emri i autorit dhe burimi, përveç nëse një gjë e tillë nuk është e mundur;*
- 9) *përdorimi i fjalimeve politike, si sekuenca nga paraqitjet publike, deri në nivel të arsyeshëm për qëllim të informimit, por me kusht që të theksohet autori dhe burimi, përveç nëse një gjë e tillë nuk është e mundur;*
- 11) *përdorimi i veprave arkitektonike dhe skulpturore që janë vendosur në vende publike (rrugë, sheshe, parqe dhe ngjashëm);*
- 12) *përdorimi i veprave nga fushat e artit figurativ dhe artit të aplikuar, arkitekturës, dizajnit industrial dhe veprat fotografike që janë të vendosura në ekspozita publike ose në ankande nga ana e organizatorit, në katalogë ose pllakate të përpunuara për nevoja komerciale, deri në nivelin e duhur për promovim të ngjarjes;*
- 15) *Kyçje të rastësishme (dytësore) të ndonjë vepre të autorit, në material tjetër;*
- 17) *publikimi publik dhe vendosja në dispozicion e veprës së autorit për nevoja hulumtuese ose për përmirësim personal në vende të caktuara siç janë institucionet e ndryshme shkencore, kulturore, arsimore dhe të tjera të karakterit të ngjashëm, në rast se vepra nuk mund të blihet, ose për përdorimin e tij duhet leje, dhe është pjesë e koleksioneve ose fondeve të institucioneve.*

Paragrafi (3) nga neni 52 i Ligjit për të drejtën e autorit: *“Transmetimi i ndonjë titulli të artikullit ose shkrimit, ose ndonjë veprë tjetër për tema afariste, politike, religjioze dhe tema të tjera, në versionin elektronik të marrë nga ndonjë publikim tjetër elektronik, është pa pagesë, nëse ka për qëllim informimin e opinionit, vetëm nëse autori nuk ka vendosur ndonjë ndalesë të veçantë, por me kusht që të theksohet autori dhe burimi, përveç nëse një gjë e tillë nuk është e mundur”*

Në pjesën e pestë të Ligjit për të drejtën e autorit, duke u nisur nga neni 55, është rregulluar kohëzgjatja e të drejtës së autorit, ku shihet inkorporimi i konventave ndërkombëtare në ligjin e Maqedonisë edhe atë: *“...të drejtat materiale kanë afat sa jeta e autorit, dhe 70 vite pas vdekjes së tij, në rast se në këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe”. Është interesante të theksohet se të drejtat morale të autorit, në pajtueshmëri me Ligjin për të drejtën e autorit, vazhdojnë edhe pas skadimit të afatit për të drejtat materiale, të vërtetuara me këtë ligj.*

Neni 86 i Ligjit ka të bëjë me veprën e autorit të kryer gjatë marrëdhënieve të punës, dhe prandaj këtë nen do ta veçojmë sikur tejet të rëndësishëm për punën e gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve mediatik, pasi një problematikë e tillë është e theksuar tejet shumë edhe në shtetet e tjera, në veçanti në BE nga ana e shoqatave esnafe të gazetarëve, dhe i njëjti nen thotë: “ (1) Në rast kur vepra e autorit është krijuar nga një punonjës, gjatë kryerjes së obligimeve të tij të punës, duke ndjekur urdhrat e punëdhënësit, (më tej në tekst do t’i referohemi si kontratë pune në vepër), vlerësohet se të drejtat materiale të autorit të asaj veprë, në mënyrë ekskluzive i janë transmetuar punëdhënësit, në kohëzgjatje prej pesë vjetësh, pas mbarimit të veprës, në rast se me ndonjë marrëveshje kolektive nuk është përcaktuar diçka ndryshe nga kjo. (2) Pas skadimit të afatit nga paragrafi (1) i këtij ligji, të drejtat materiale i përkasin të punësuarit, me çka punëdhënësi mund të kërkojë përsëri që vetëm të transmetohen, në rast se të punësuarit i paguan kompensim për secilën të drejtë materiale në mënyrë të veçantë. (3) Pavarësisht paragrafëve (1) dhe (2) nga ky nen, autori ka të drejtën e kompensimit për secilin huazim. (4) Autori nuk ka mundësi që të heq dorë nga e drejta e paragrafit (3) nga ky nen”.

Nenet 129-131 nga Ligji për të drejtën e autorit, kanë të bëjnë me menaxhimin kolektiv të të drejtës së autori dhe të drejtave të tjera të përafërta që menaxhohen në mënyrë kolektive. Ndërsa **nenet 132-134** e rregullojnë organizimin për menaxhim kolektiv.

Kjo pjesë e ligjit qartëson se bartësit e drejtave autoriale dhe të drejtave të përafërta, mund t'i realizojnë të drejtat e tyre të garantuara me ligj në mënyrë individuale (në mënyrë të veçantë për secilën vepër të autorit, respektivisht lëndë të drejtës së përafërt), në mënyrë personale, respektivisht nëpërmjet përfaqësuesit, ose në mënyrë kolektive (së bashku për më shumë vepra ose lëndë të veprave të përafërta, ose për më shumë bartës të drejtës autoriale) nëpërmjet organizimit për menaxhim kolektiv me të drejtat, në mënyrë dhe kushte të caktuara me këtë ligj. Menaxhimi kolektiv përfshin çështje juridike të përdoruesve të drejtave të autorëve, grumbullimi i kompensimeve për shfrytëzimin, shpërndarja e tyre dhe mbrojtja e të drejtave para organeve shtetërore dhe subjekteve të tjera. Menaxhimi kolektiv realizohet nëpërmjet një organizate joprotabile për menaxhim kolektiv, e cila është e themeluar nga bartësit e të drejtave të cilët mund të jenë persona fizik ose juridik.

Organizata për menaxhim kolektiv me të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të përafërta paraqet një person juridik që është themeluar nga bartësit e të drejtave, (persona fizik ose juridik janë persona që punojnë në emrin e tyre, në llogari të bartësve të të drejtave dhe në bazë të një leje nga Ministria e Kulturës. Ky lloj i organizatës llogaritet si joprotabile dhe e njëjta mund të themelohet për të drejta të caktuara që u takojnë bartësve të caktuar. Organizata posedon dispozita taksative ligjore të theksuara në nenin 133 të Ligjit për të drejta të autorit, dhe me të njëjtën menaxhojnë dhe vendosin anëtarët e organizatës (bartësit e të drejtave) s, respektivisht, menaxhon me të drejtat e të gjithë bartësve të të drejtave për të cilat ka marrë leje nga Ministria e Kulturës, në pajtueshmëri me këtë ligj dhe statutin, respektivisht me marrëveshjen me themelim. Organizatat për menaxhim kolektiv, në pajtueshmëri me Ligjin për të drejta të autorit, janë të kyçur në mënyrë të drejtpërdrejtë në sjelljen e një tarife, respektivisht kompensimi për shfrytëzimin e të drejtave të autorit, dhe lëndëve të të drejtave të përafërta me të cilat po ashtu menaxhon, si dhe ndjekë shfrytëzimin e të drejtave nga bartësit e të njëjtave. Organizatat për menaxhim kolektiv i grumbullojnë kompensimet e përcaktuara nga shfrytëzuesit dhe i shpërndajnë pastaj ato tek bartësit e të drejtave në pajtueshmëri me ligj me akte të përgjithshme.

KRAHASIM I LIGJIT KROAT PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA ME LIGJIN E MAQEDONISË QË NDIKON NË PUNËN E GAZETARËVE, FOTOREPORTERËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK

Një diferencë e rëndësishme e cila ka të bëjë me veprat autoriale të krijuara gjatë marrëdhënies së punës, të cilat në ligjin kroat janë parashikuar me nenin 76 është kjo:

“Nëse gjatë kryerjes së detyrave nga marrëdhënia e punës, krijohen vepra autoriale, në marrëveshjen e punës rregullohet mes tjerash edhe fakti nëse punëdhënësi do të fitojë të drejtën e veprës autoriale për shfrytëzim, dhe nëse e fiton e të drejtën për sa kohë do të jetë kjo e drejtë në dispozicion për shfrytëzim. Nëse me këtë ligj, marrëveshja e punës ose ndonjë akt tjetër me të cilin rregullohet marrëdhënia e punës, nuk ka përcaktuar diçka ndryshe, atëherë e drejta e autorit mbi veprën e autorit qëndron tek vetë autori, pa kufizime”.

Nëse i krahasojmë të dy nenet, nenin 86 nga Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta, dhe nenin 76 nga ligji kroat, mund të konstatojmë se në ligjin kroat për vepra autoriale të krijuara gjatë marrëdhënies së punës, theksi më i madh vendoset tek autori. Në ligjin kroat, të drejtat materiale të autorit për veprën e krijuar gjatë marrëdhënies së punës, i takojnë vetëm atij, përveç nëse me ndonjë marrëveshje tjetër, nuk është rregulluara ndryshe. Për dallim prej tij, në ligjin e Maqedonisë, të drejtat materiale me automatizëm i kalojnë punëdhënësit në afat prej pesë vitesh nga krijimi i veprës, përveç nëse me ligj nuk është caktuar diçka tjetër.

Një specifikë tjetër e ligjit kroat që nuk është e përfshirë në Ligjin për të drejtën e autorit, ka të bëjë me menaxhimin multi-territorial të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta. Kjo do të thotë se bartësit e të drejtave të autorit, kanë të drejtë që me vendim personal, të zgjedhin dhe të autorizojnë ndonjë organizatë për realizim të të drejtave autoriale në cilindo shtet të Bashkimit Evropian, pavarësisht se cila është shtetësia e autorit, ose pavarësisht se ku e ka vendqëndrimin ose marrëdhënien e punës. Këto dispozita janë sjellë me Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për të drejta të autorit dhe të drejta të përafërta të Kroacisë, në vitin 2017, dhe janë në pajtueshmëri me Direktivën 2014/26/EC për menaxhim kolektiv me të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta, si dhe licencimin multi-territorial të veprave muzikore për përdorim në internet.

Përveç këtyre dallimeve, të dy ligjet kryesisht janë të ngjashme dhe nuk ka dallime të tjera më të mëdha në pjesët që i tangojnë gazetarët, fotoreporterët dhe punonjësit mediatik.

PRAKTIKA E MENAXHIMIT KOLEKTIV ME TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA TË GAZETARËVE DHE FOTOREPORTERËVE NË KROACI

Elemente të rëndësishme nga ligji kroat tek të cilat do ishim ndalur, janë procedura për ndarje të lejeve për organizata për menaxhim kolektiv me të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta, mënyrën e ndjekjes së shfrytëzimit të të drejtës autoriale dhe të drejtave të përafërta, mënyrën e konstatimit të lartësisë së kompensimeve, grumbullimin e tyre dhe shpërndarjen.

Enti shtetëror për pronësi intelektuale i Republikës së Kroacisë, është kompetent për organizimin e të drejtës së autorit dhe të drejtës së përafërt e cila lëshon autorizime ose leje për menaxhim kolektiv me të drejtën autoriale dhe të drejtat e përafërta të organizatave të cilat plotësojnë kushte të caktuara, si për shembull: të ketë seli ose përfaqësi në një shtet anëtar i Bashkimit Evropian, të posedojë hapësirë adekuate, pajisje dhe burime njerëzore, dhe realizimin kolektiv të të drejtave autoriale ta ketë veprimtari kryesore ose të vetme. Në Kroaci, procedura për ndarjen e lejeve për organizata të cilat duan të merren me veprimtarinë e menaxhimit kolektiv me të drejtat autoriale, është e rregulluar me akt nënligjor të Këshillit të ekspertëve për kompensime në fushën e të drejtës autoriale dhe të drejtave të përafërta. Një organizatë për menaxhim kolektiv doemos duhet të plotësojë kushtin që të jetë pronë ose të jetë nën kontroll të anëtarëve të saj, dhe të jetë e regjistruar si organizatë jofitimprurëse.

Në bazë të autorizimeve të saj, organizata e cila menaxhon në mënyrë kolektive me të drejtat e autorit, mund që të kontrollojë shfrytëzimin e lëndëve që janë nën mbrojtje, e për të cilat ekziston leje për menaxhim kolektiv. Shfrytëzuesit obligohen që t'i japin organizatës të dhëna relevante për përdorimin. Me kërkesë të autorit dhe organizatës për menaxhim kolektiv, policia mund të ndalojë mbajtjen e ndonjë ngjarjeve në të cilat do të përdoren mjete që janë të mbrojtura dhe për të cilat nuk ekziston leje për shfrytëzim.

Kompensimi për shfrytëzim dhe kushtet e tjera të përdorimit, vërtetohen me marrëveshje mes organizatës për menaxhim kolektiv dhe shfrytëzuesit ose odës së shfrytëzuesve, ose në mes ndonjë shoqate tjetër të shfrytëzuesve.

Në rast se nuk është përkufizuar çmimi, atëherë pagesa bëhet sipas tarifës. Tarifa konstatohet me mendim nga oda ose ndonjë shoqatë tjetër e shfrytëzuesve. Në rast se tarifa nuk pranohet, atëherë mund të vihet në funksion arbitrimi, ose secili kontest për konstatimin e tarifës, mund të zgjidhet nëpërmjet arbitrimit

Në rast se arbitrimi dështon, atëherë organizata për menaxhim kolektiv mund të kërkojë mendim edhe nga Këshilli i ekspertëve për kompensime në aspekt të të drejtës autoriale dhe të drejtave të përfaqësuara.

Në Republikën e Kroacisë, në vitin 2007 është themeluar **Shoqata për mbrojtje të të drejtave autoriale të gazetarëve**¹⁵ e cila qëllimin kryesor e ka mbrojtjen kolektive të të drejtave autoriale të gazetarëve. Sipas nenit 2 nga statuti i kësaj shoqate, bëhet fjalë për një shoqatë civile jofitimprurëse, e cila është e themeluar nga gazetarë, dhe që financohet nga donacione dhe anëtarësia. Anëtar i Shoqatës mund të bëhet çdo gazetar që do të qaset në organizatë vullnetarisht.

Qëllimi i kësaj organizate është bashkimi i gazetarëve-autorë, mbrojtja e të drejtave autoriale të autorëve, realizimi i interesave të përbashkëta profesionale dhe përmirësimi i pozitës sociale dhe materiale të gazetarëve.

Bazuar në mendimin e Shoqatës për mbrojtje të të drejtave autoriale të gazetarëve nga Kroacia, gjatë viteve të fundit të ekspansionit në sferën digjitale dhe internet, në vend se të kemi prodhim të shtuar të përmbajtjeve autentike gazetareske, po ndodh e kundërta. Portalet kroate të internetit, e shfrytëzojnë rrjetin e pazhvilluar të mbrojtjes së të drejtave autoriale të gazetarëve, kështu që në vend se të prodhojnë përmbajtjen personale, ata kopjojnë nga mediat e shkruara, dhe nga portalet e rralla të internetit që kanë redaksi gazetarësh.

Në praktikë, kjo bëhet në mënyrë që, pas publikimit të një prodhimi origjinal gazetaresk, portalet bëjnë gara se kush do ta kopjojë i pari, dhe nuk shkruhen as burimet e as autori i tekstit, ndërsa rrallë herë, shkruhet vetëm burimi me një shkurtesë në fund të publikimit, pa shkruar adresën e saktë të burimit ose pa vendosur hallkë (lidhëse) i cili të çon tek teksti origjinal. Për momentin po punohet në një model të shfrytëzuesve të teksteve gazetareske, që do të obligohen për të

¹⁵ Shoqata për mbrojtje të të drejtave autoriale gazetareske në Republikën e Kroacisë <https://www.dznep.hr/> qasur më 20.07.2018

paguar kompensim, respektivisht do të obligohen të kërkojnë formalisht leje për publikimin e teksteve.¹⁶

Sipas ndryshimeve në rregullativën ligjore të Kroacisë, për të drejta autoriale dhe të drejta të përafërta, që në mënyrë të drejtpërdrejtë tangojnë gazetarët, fotoreporterët dhe punonjësit mediatik, dhe në fushën e menaxhimit kolektiv me të drejtat, rregullohet që¹⁷:

- *Bartësit e të drejtave të autorit, kanë të drejtë që të zgjedhin dhe autorizojnë ndonjë organizatë për realizim kolektiv të të drejtave në cilindo shtet të Bashkimit Evropian, Kjo organizatë do të menaxhojë me të drejtat e tij, me kategoritë e të drejtave ose veprave të llojeve të tjera që i përzgjedh vetë autori, për shtete që vetë ai i përzgjedh, pavarësisht se shtetas i cilit shtet është, ose ku e ka vendbanimin ose ku është në marrëdhënie pune.*
- *Shoqata për mbrojtje të të drejtave autoriale të gazetarëve do të pranojë menaxhimin me të drejtat e këtylla, me kategoritë dhe llojet e tilla të të drejtave, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive për tu refuzuar një autorizim i tillë.*
- *Bartësi i të drejtave të autorit ka të drejtë që të lëshojë leje për përdorim jokomercial të çfarëdo të drejtave, kategorive të të drejtave dhe veprave të tjera të cilat do t'i përzgjedhë vetë. Shfrytëzim jokomercial llogaritet momenti i përdorimit kur në asnjë mënyrë direkte ose indirekte, nuk realizohet përfitim ekonomik.*
- *Bartësi i të drejtave të autorit, mund ta anulojë autorizimin për menaxhim të cilin ia ka lëshuar Shoqata për mbrojtje të të drejtave autoriale gazetareske në Republikën e Kroacisë në tërësi, ose mund të anulojë të drejtën për ndonjë kategori, vepër të ndryshme të cilën e përzgjedh vetë, për fusha shtetërore të cilat vetë i përzgjedh, me një vendim për anulim që nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë muaj. Kjo pavarësisht nëse në të njëjtën kohë, autorizimin e tillë ia ka dhënë ndonjë organizatë tjetër për menaxhim kolektiv me të drejtat, dhe me këtë vendim për anulim, prodhon pasoja deri në fund të vitit financiar, përveç nëse Shoqata për mbrojtje të të drejtave autoriale gazetareske në Republikën e Kroacisë nuk vendosë në mënyrë tjetër.*
- *Në rast të anulimit të autorizimit, bartësi i të drejtës i ruan të gjithë të drejtat ndaj Shoqatës për mbrojtje të të drejtave autoriale gazetareske në Republikën e Kroacisë,*

¹⁶ Artikull i publikuar në Dojçe Vele në gjuhën kroate, autor Sinisha Bogdanović, publikuar më 13.04.2011. <https://www.dw.com/hr/imaju-li-u-hrvatskoj-novinari-autorska-prava/a-14983571-1> qasur më 20.07.2018.

¹⁷ Risi për Ligjin për të drejta të autorit në Kroaci, publikuar më 9.11.2017. <https://www.dznap.hr/odrzana-4-medunarodna-autorska-kreativna-konferencija/> qasur më 22.07.2018.

lidhur me benefitet që janë realizuar dhe lejet që Shoqata i ka lëshuar, para momentit të anulimit. Secili autorizim për menaxhim me të drejtat dhe anulim i autorizimit të tillë, doemos duhet të jenë në formë të shkruar, duke theksuar të drejtat individuale, kategoritë e të drejtave dhe llojet e lëndëve për të cilat bëhet fjalë.

PRAKTIKA E GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË MBROJTJE TË TË DREJTËS SË AUTORIT DHE LIRISË SË SHPREHJES, LIDHUR ME PUNËN E GAZETARËVE, FOTOREPORTERËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK

Praktika e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut në Strasburg, lidhur me mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe lirisë së shprehjes, nuk është voluminoze. Një prej verdikteve më me rëndësi në kontekst të temës së kësaj analize është *“Eshbi Donald dhe të tjerët kundër Francës” (Ashby Donald and others v France, numri i aplikimit 36769/08).*

Sipas profesorit Dirk Vorhof¹⁸ nga Universiteti në Gent, për herë të parë shpjegon se një verdikt në bazë të ligjit për të drejta të autorit, për riprodhim joligjor ose publikim të materialit të mbrojtur me të drejta të rezervuara, mund të llogaritet si përzjerje në të drejtën e lirisë së shprehjes, sipas nenit 10 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut. Përzjerja e tillë doemos duhet të jetë në pajtueshmëri me tre kushtet e parapara në paragrafin 2 të nenit 10 nga Konventa. Kjo do të thotë se dënimi ose cilido vendim tjetër gjyqësor i bazuar në të drejtën e autorit, duke kufizuar lirinë e shprehjes së një personi ose organizate, duhet të jetë e patjetërsueshme në një shoqëri demokratike, të jetë e paraparë me ligj, dhe të posedojë një qëllim legjitim.

Në mënyrë shtesë, nuk mund të ketë arsyetim për një dënim i cili e kufizon lirinë gazetareske ose artistike të shprehjes, duke u bazuar në shkelje të dispozitave të Ligjit për të drejtat e autorit. Por, as nuk mjafton që të merret parasysh se shfrytëzimi i paautorizuar, riprodhimi ose publikimi i një vepre, nuk duhet të mbështetet në disa përjashtime të interpretuara në një rreth të ngushtë, në vetë ligjin për të drejta të autorit, duke përfshirë edhe zbatimin e të ashtuquajturit, test të tre hapave (neni 5.5 Direktiva e BE-së, 2001/29 nga 22 maji i vitit 2001).

¹⁸ Blogu i Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, analizë e profesor. D.r Dirk Vorhof, nga data 22.01.2013 <http://echrblog.blogspot.com/2013/01/copyright-vs-freedom-of-expression.html> qasur më 23.07.2018

Verdikti i Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, nga 10 janari i vitit 2013, në rastin Eshbi Donald dhe të tjerët, kundër Francës, pa mëdyshje se e deklaroi nënin 10 të Konventës si të zbatueshëm në rastet e të drejtave të autorit që përzihen me të drejtën e lirisë së shprehjes dhe informimit e të tjerëve, duke shtuar se perspektivë të jashtme për të drejtat e njeriut tek arsyeshmëria e zbatimit të të drejtave të autorit. Për shkak të marginës së gjerë të vlerësimit që e kanë në dispozicion autoritetet kombëtare në këtë rast, ndikimi i nenit 10 megjithatë është tejet modest dhe minimal.

Aplikuesit në këtë rast kanë qenë Robert Eshbi Donald, Marsio Madeira Moraesh dhe Olivie Kles, respektivisht një amerikan, një brazilian dhe francez të cilët kanë jetuar në Nju Jork, Paris dhe Perusir Man. Të tre kanë punuar si fotografë në industrinë e modës. Ata janë dënuar në Francë për publikimin e disa fotografive të kompanisë së modës që është pronë e Donald dhe Morales, në ueb faqen Viewfinder. Fotografitë i kishte shkrepur Olivie Kles, në revistë të modës në Paris, në vitin 2013, dhe janë publikuar pa leje të shtëpive të modës. Të tre fotografët ishin dënuar nga Gjykata e Apelit në Paris, dhe ishin obliguar që të paguajnë gjoba në lartësi prej 3 mijë deri në 8 mijë euro. Por është dashur të paguajnë edhe dëmshpërblim për Federatën e veshjes së disenjatorëve të Francës dhe pesë shtëpi të modës, në lartësi prej 255 mijë eurosh. Të tre fotografët është dashur të paguajnë edhe publikimin e vendimit gjyqësor në tre media të shkruara. Argumentet e tyre i kishte refuzuar edhe Gjykata Supreme e Francës pasi sipas ligjit francez për të drejtat e autorit, lejohet riprodhimi dhe publikimi i veprave autoriale, vetëm me qëllim të informimit të opinionit dhe për qëllime të ngjashme.

Në Gjykatën e Strasburgut, aplikuesit ishin ankuar për shkelje të të drejtave të tyre nga neni 10 i Konventës. Gjykata e ka pranuar aplikimin e tyre por ka ardhur në konkluzion se dënimi i aplikuesve për shkak të shkeljeve të ligjit të Francës për të drejtat e autorit, nuk do të thotë se autoritetet franceze kanë bërë shkelje të nenit 10 të Konventës.

Gjykata ka konkluduar se dënimi për shkeljen e të drejtave autoriale dhe kompensimi i dëmit, me të vërtetë mund të konsiderohen si shkelje e të drejtës së lirisë së shprehjes dhe informimit, por se ka patur kufizime të caktuara me ligj, dhe kështu me vendimin është arritur qëllimi legjitim për mbrojtje të të drejtave të të tjerëve, dhe ka qenë diçka e domosdoshme për një shoqëri demokratike.

Gjykata në këtë rast i ka dhënë një marginë më të gjerë të drejtës, autoriteteve franceze. Kjo pasi publikimi i fotografive të modeleve nëpër revistë e modës, si dhe veshja e disenjatorëve e shfaqur në pistat e modës në Paris, nuk kanë pasur ndonjë interes të veçantë shoqëror, dhe më shumë kanë qenë një "fjalim komercial".

Vendet anëtare që kanë nënshkruar Konventën, janë në pozicion që t'i balancojnë të drejtat dhe konfliktet e interesit, dhe e tillë është edhe liria e shprehjes sipas nenit 10 nga Konventa, me të drejtën e mbrojtjes së pronësisë nga neni 1 i protokollit 1 nga Konventa.

Dy elemente kyçe në këtë rast e arsyetojnë veprimin e autoriteteve franceze. Këto elemente janë "fjalim komercial", respektivisht, karakteri i publikimit të fotografive në ueb faqe dhe balancimi të cilin gjykata duhet ta merr parasysh në kontekst të ndeshjes së të drejtave të garantuara me nenin 10 të Konventës, dhe të drejtën e mbrojtjes së pronësisë sipas nenit 1 nga protokollit 1 i Konventës. Gjykata në Strasburg thirret edhe në Gjykatën e Apelit në Francë, duke thënë se aplikuesit, kanë riprodhuar dhe prezantuar fotografi, pa lejen e bartësve të të drejtës autoriale, dhe me këtë, ata i kanë shkelur të drejtat për pronësi intelektuale të të tjerëve.

Gjykata Evropian përfundimisht ka vlerësuar se dënimet dhe kompensimi i dëmit nuk janë në disproporcion me qëllimin legjitim, duke argumentuar se aplikuesit nuk kanë dhënë prova se me këto sanksione, do të rrënohej stabiliteti i tyre financiar.

Në kontekst të këtyre rrethanave, dhe duke marrë parasysh margjinën e gjerë të miratimit të autoriteteve franceze, Gjykata ka vlerësuar njëzëri se nuk ekziston shkelje e nenit 10 nga Konventa.

DOMETHËNIA E VERDIKTIT

Ky verdikt ilustron faktin se rastet e gjoja shkeljeve të të drejtave dhe lirive themelore, që janë të garantuara me Konventën dhe protokollin e saj, në sferën digjitale, on-line, ngadalë por sigurtë e gjetën rrugën deri tek Gjykata për të drejtat e njeriut. Kohëve të fundit gjykata ka sjellë disa vendime në të ashtuquajtura "raste të internetit" të lidhura me lirinë e shprehjes dhe informimit, siç janë Times Newspapers Ltd. v. United Kingdom (ECtHR 10 mars 2009), Editorial Board of Pravoye Delo and Shtekel v. Ukraine (5 maj 2011 dhe vendimi i këshillit të madh gjyqësor Mouvement Raëlien Suisse v. Switzerland (13 korrik 2012).

Verdiktin e 10 janarit të vitit 2013 nga Eshbi Donald dhe të tjerët kundër Francës, e cila ka të bëjë me shkeljen e të drejtës autoriale duke publikuar fotografi të një

faqe interneti, sigurisht që është i pari në këtë gjykatë, por nuk do të jetë i fundit i lidhur me të drejtën e autorit dhe internetin.

Ky verdikt është ilustrim i qartë i dallimit mes njëres anë, ku qëndron shprehja dhe përmbajta e cila kontribuon për hapjen e debatit publike me interes shoqëror, dhe anës tjetër ku qëndron “fjalimi komercial”. Fjalimet, mesazhet dhe përmbajtjet që bëhen vetëm për qëllime komerciale, nuk e gëzojnë vlerën e shtuar të të drejtës së lirisë së shprehjes që e garanton neni 10 i Konventës. Sipas pikëpamjes së gjykatës, margjina e miratimit në këto raste është tejte e gjerë, dhe madje edhe në raste kur përzierja e autoriteteve është në formën e akuzës penale ose dënimit të lartë për kompensim të dëmit, dhe që të dy sanksionet janë me një rrezik nga “efekti i ftohjes” ose “chilling effect”.

Gjithë epilogu i këtij rasti do ishte ndryshe në rast se fotografitë e publikuara në ueb faqen e internetit, do kishin kontribuar për debat publik, respektivisht si shembull për të drejtat e grave në botën e modës, ose të shëndetit të modeleve duke e lidhur me anoreksinë dhe ngjashëm. Në rastin tonë, fotografitë ishin shfrytëzuar vetëm për qëllime komerciale dhe publikimi i tyre nuk është bërë me mesazhe shtesë. Është me rëndësi që të theksohet nëse publikimi, artikulli, japin kontribut për debat publik në interes të shoqërisë.

Një arsye e rëndësishme përse gjykata ka pranuar në këtë rast një margjinë të gjerë të miratimit, është se doemos duhet të gjendet një balancim mes ndeshjes së dy të drejtave fundamentale që janë të garantuara me Konventë, dhe protokollet e saj. Në këtë kontekst, gjykata është e obliguar që të verifikojë nëse autoritetet vendore, i kanë mbrojtur të dy të drejtat e garantuara me Konventë në mënyrë të balancuar. Në këtë rast, gjykata duhet nga njëra anë që të balancojë mes lirisë së shprehjes në bazë të nenit 10, dhe të drejtës së mbrojtjes së pronësisë, në pajtueshmëri me nenin 1 nga protokollin 1, sidomos kur në bazë të praktikave të gjykatës tek rastet *Anheuser-Busch Incl. v. Portugal* dhe *Melnychuk v. Ukraine* ku vendosi se neni 1 nga protokollin 1 është i zbatueshëm kur bëhet fjalë për pronësi intelektuale, dhe të drejtës së mbrojtjes së pronësisë.

Edhe pse gjykata në këtë rast nuk kishte vërejtur shkelje të nenit 10 të Konventës, verdikti konstatoi se e drejta e autorit dhe restriksionet për shfrytëzim të një materiali të mbrojtur apo veprë të një autori, dhe sanksionet për shkeljen e këtyre të drejtave, në fund të fundit, mund të vlerësohen si përzierje në lirinë e shprehjes dhe të informimit. Megjithatë mbetet e pasigurtë se si do të zbatohet neni 10 në të ardhmen, kur do të ketë raste të mbrojtjes së të drejtave autoriale të cilat i cenojnë të drejtat e lirisë së shprehjes.

PRAKTIKA VENDORE LIDHUR ME MBROJTJEN E TË DREJTËS SË AUTORIT NË PUNËN E MEDIAVE, GAZETARËVE, FOTOREPORTERËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK

Një rast interesant nga praktika vendore gjyqësore që e tangon punën e gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve mediatik, dhe personat juridik-mediat, është një rast i cili është zhvilluar para Gjykatës Themelore Shkupi 2 në Shkup, ku si paditës paraqitet një person i huaj që është fotograf, ndërsa i padituri është person juridik, pronar i një ueb portali. Verdicti i njëjtë¹⁹ që është marrë nga portali gjyqësor www.sud.mk, është i nivelit të parë dhe deri në publikimin e kësaj analize, nuk është publikuar vendimi i shkallës së dytë, pas ankesës për vendimin. Nuk ka informatë nëse gjykata ka vepruar në bazë të ankesës.

Faktet e këtij rasti flasin se paditësi ka qenë autorë i fotografisë me fytyrën e një muzikanti të njohur ballkanik, e që është shfrytëzuar për ilustrim të një artikulli në portalin e të paditurit. I padituri në kundërshtim me Ligjin për të drejtën e autorit dhe të drejtave të përafërta, e ka eksponuar, publikuar fotografinë pa dijen dhe miratimin e autorit, edhe atë për qëllime komerciale. Secili publikim, shfrytëzim ose shumim i veprës nga ana e personave të tretë, është në kundërshtim me dispozitat nga Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Me padinë, paditësi kërkon nga gjykata që të konstatohet se ai është autor i fotografisë dhe kërkon që të konstatohet se i padituri, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për të drejtë të autorit dhe të drejtat e përafërta, ka bërë shkelje të të drejtave materiale dhe morale që burojnë nga vepra e paditësit, në këtë rast fotografia, pasi të njëjtën e ka publikuar pa lejen e autorit.

Gjykata ka vërtetuar se paditësi – person i huaj fizik, para më shumë vitesh, e ka fotografuar një këngëtar të njohur ballkanik në një koncert jashtë Maqedonisë. I padituri në portalin e tij e ka publikuar fotografinë, si pjesë e tekstit për këngëtarin. Gjykata e ka vërtetuar autorësinë e fotografisë nga provat e nxjerra (fotokopje nga fotografia ku në pjesën poshtme, në të djathtë figuron emri i autorit, qasje deri tek negativi origjinal i fotografisë, segment nga ueb faqja e të paditurit, fotokopje nga afishja me të njëjtën fotografi ku duket interpretimi i këngëtarit në koncerte

¹⁹ Verdict P1-287/17 nga 05.02.2018 në Gjykatën Themelore Shkupi 2 Shkup http://sud.mk/wps/portal/central/sud/odluki/lut/p/z1/04_Sj9CPyKssy0xPLMnMz0vMAfljo8zizdxNTAwsvA183ANCzQ0cfV0M-PEIsvYwsjMz0w_EpcDc304-iQD9IAUi_AQ7gaADVj0cBQfujCFkRhc8MkbcjgW4wRyjw93ADKgh1N-TR1tAg0MnEx1w8GmZGZW5CTmZxZ4pufkpqjH1ISVJqqX5AbGhphkGVakK6oCADGFdsn/p0/IZ7_6G4408K0LOHF70AUE15A8Q24D7=CZ6_6G4408K0LGPU70AMD0HT9J2826=NJdocumentDownload=?-caseId=D9F16AEB-3972-41F8-804A-7EC50FDD7730&connected=false, qasur më 27.07.2018.

e të tjerë) dhe nga ekspertiza e fushës së të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta. Gjykata ka vërtetuar se me publikimin e fotografisë së autorit në ueb faqen e të paditurit, është shkelur e drejta materiale e paditësit, dhe duke marrë parasysh se nuk është theksuar as emri i autorit në fotografinë e publikuar, i njëjti e ka shkelur edhe të drejtën morale të paditësit.

Gjykata në këtë rast i ka vlerësuar edhe pohimet e të paditurit se paditësi, të drejtën autoriale të fotografisë e ka siguruar në Entin për pronë intelektuale në shtetin amë, tek pasi ishte publikuar në ueb faqe, dhe se gjatë periudhës së publikimit, nuk ka patur asnjë lloj të mbrojtjes së të drejtave të autorit, por këto pohime gjykata nuk i ka pranuar. Në bazë të nenit 17, paragrafi 2 nga Ligji për të drejtën e autorit, atij i përket e drejta autoriale mbi veprën e tij, prej momentit kur e krijon veprën. Në mënyrë shtesë, gjykata nuk i ka pranuar as pohimet e të paditurit se paditësi, nuk ka arritur të dëshmojë se ka marrë leje nga këngëtari për ta fotografuar, pasi që kjo *“paraqet marrëdhënie interne mes autorit si fotograf dhe personit të fotografuar, dhe nëse ai është fotografuar pa lejen e tij, do të kishte nisur procedurë penale kundër tij dhe kjo do të ishte lëndë vlerësimi në gjykatë”*.

Gjykata ka sjellë vendim me të cilin është pranuar padia e paditësit, respektivisht autorit të fotografisë, pasi që fillimisht është konstatuar se paditësi është autori i fotografisë me personazhin e muzikantit të njohur ballkanik, e publikuar në ueb portalin e të paditurit dhe konfirmon se i padituri “Në mënyrë të palejuar dhe në kundërshtim me Ligjin për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta, ka kryer shkelje të të drejtave morale dhe materiale që burojnë nga vepra fotografike e paditësit, në mënyrë që e ka publikuar fotografinë e muzikantit pa lejen e autorit të fotografisë”.²⁰

Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë plotësuese e obligon të paditurin që t'i kompensojë paditësit shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 344.030,00 denarë, prej të cilave: për formulimin e padisë shumë prej 46.800 denarë, shpenzime për kryerjen e ekspertizës në shumë prej 30.000 denarë, shpenzime për formulimin e dy parashtrësive argumentuese në shumë prej 93.600 denarë, shpërblim për pjesëmarrjen e të autorizuarit të paditësit në tre seanca në vlerë prej 168.480 denarë, taksa për padi në vlerë prej 1.200 denarë, taksa për vendim në vlerë prej 1.200 denarë dhe shpenzime të tjera materiale në vlerë prej 2750 denarë. Është me rëndësi të përmendet se shpenzimet janë rritur për 100% sepse paditësi ka qenë shtetas i huaj, në pajtim me nenin 3 të Tarifës së Avokatëve.

²⁰ Kopje nga verdikti i marrë nga portali gjyqësor www.sud.mk

Në drejtim të praktikës gjyqësore të vendit, koment në analizë jep edhe Dragan Sekullovski, drejtori i përgjithshëm i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM). Sipas Sekullovskit: *“është mirë që gjykatat i mbrojnë autorët nga shkelja e të drejtave të autorit dhe keqpërdorimin e tyre sepse vetëm përmes mbrojtjes gjyqësore të të drejtës së autorit do të parandalohet plagjiatura dhe do të mbrohet munda i gazetarëve dhe fotoreporterëve nga marrja e padrejtë e përmbajtjeve autentike. Nga ana tjetër, shpenzimet gjyqësore për këto procese janë shumë të larta dhe për këtë shkak gazetarët dhe fotoreporterët në Maqedoni shpesh janë të penguar që të kërkojnë drejtësinë para gjykatës, edhe pse shpesh shkelen të drejtat e tyre të autorit”.*

KODI ETIK I GAZETARËVE DHE POLITIKAT E FEDERATËS EVROPIANE TË GAZETARËVE NË MBROJTJE TË TË DREJTËS SË AUTORIT DHE PUNONJËSVE MEDIATIK

Kodeksi etik i gazetarëve të Maqedonisë²¹ nga viti 2001, i vendos principet themelore për punën e gazetarëve sipas shembullit të parimeve të etikës së Federatës Ndërkombëtare të gazetarëve. Në parimet themelore të këtij Kodi thuhet se: *“gazetarët kanë rolin që të transmetojnë informacione, ide dhe mendime, dhe kanë të drejtë edhe të komentimit. Duke respektuar vlerat etike dhe standardet profesionale në transmetimin e informacioneve, gazetarët do të jenë të ndershëm, objektiv dhe të saktë”.*

Kodeksi përbëhet prej 17 principeve të cilat japin udhëzime se si një gazetar duhet të jetë etik dhe profesional në punën e tij. Principi numër 12 ka të bëjë pikërisht me të drejtën e autorit dhe e njëjta thotë: *“Plagjiatura është e papranueshme. Citatat nuk guxon të shfrytëzohen pa u theksuar burimi ose autori”.* Kjo do të thotë se secili gazetar i cili pa leje të autorit, do të vjedhë dhe pastaj ripublikojë një produkt gazetaresk, pavarësisht se a bëhet fjalë për tekst autentik gazetaresk, vepër mediatike audiovizuale ose fotografi, ose ndonjë prodhim tjetër i cili mund të burojë nga fotografia, e shkel Kodeksin e gazetarëve.

Princip të ngjashëm takojmë edhe tek Deklarata²² e principeve për sjellje të gazetarëve nga Federata ndërkombëtare e gazetarëve (FNG), organizata më e madhe e shoqatave të gazetarëve dhe sindikatave të gazetarëve në botë.

²¹ Kodeksi etik i gazetarëve të Maqedonisë http://znm.org.mk/?page_id=1412 qasur më 25.07.2018

²² Deklarata e principeve të sjelljes të gazetarëve nga Federata evropiane e gazetarëve (FEG) <http://www.ifj.org/about-ifj/ifj-code-of-principles/> qasur më 25.07.2018

Deklarata e cila ka 9 principe, në nenin 8 thekson se plagjiatura konsiderohet si një shkelje serioze profesionale, nëse të njëjtën e ka bërë një gazetar. Kjo Deklaratë e miratuar në vitin 1954 dhe pastaj edhe e ndryshuar në vitin 1986, është e pranuar nga të gjithë anëtarët e Federatës ndërkombëtare, në mesin e të cilëve edhe Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), si dhe Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punonjësve mediatik.

Përveç Deklaratës, Federata ndërkombëtare e gazetarëve organizon edhe më shumë aktivitete në fushën e mbrojtjes së të drejtave të autorit. Kështu, në kuadër të Federatës ndërkombëtare, funksionon edhe grupi i ekspertëve i përbërë nga 12 gazetarë dhe juristë nga më shumë vende evropiane dhe SHBA-të të cilët mbajnë mbledhje të rregullta me qëllim që identifikimit të rreziqeve që e kërcënojnë të drejtën e autorit, dhe bën plane për mbështetje të punës së gazetarëve në këtë fushë.

Ky grup i punës, nëpërmjet Federatës, i përfaqëson qëndrimet se gazetarët duhet të njihen si autorë të përmbajtjes që e krijojnë, pastaj të kenë të drejtë mbi atë përmbajtje si një kompensim adekuat për publikimin.

Grupi i ekspertëve për të drejtat e autorit, vlerëson se këto të drejta të gazetarëve dhe punonjësve mediatik, më së shumti mbrohen në Evropën kontinentale, dhe njëkohësisht e kritikon modelin anglo-sakson sipas të cilit, sipas tyre, i privon gazetarët nga këto të drejta.

Interesante është që grupi i ekspertëve promovon një fuqi të fortë të mbrojtjes tek gazetarët, sipas shembullit të përfaqësuar në shtetet e Evropës kontinentale, ku fotoreporterët dhe punonjësit e tjerë mediatik, të drejtat e tyre morale në kontekst të të drejtave autoriale, si për shembull e drejta për emërim të autorit dhe e drejta që përmbajtja e tyre të mos përdoret në kontekst negativ.

E drejta e individëve që të kenë kontroll mbi përmbajtjet e tyre mediatike është kyçe për ruajtjen e standardeve të larta etike që pastaj garantojnë një gazetari kualitative.

Një prej fenomeneve shqetësuese të cilat i kundërshton Grupi i ekspertëve, është praktika e shpeshtë në vendet evropiane për të lidhur marrëveshje me gazetarët dhe punonjësit mediatik, duke iu marrë ose cenuar e drejta e autorit mbi veprat e tyre. Si rezultat e kësaj, ata kanë organizuar një fushatë publike²³ me të cilën

²³ Fushatë për marrëveshje korrekte për gazetarët nga FNG, FEG <http://europeanjournalists.org/fair-contracts-for-journalists/> qasur më 27.07.2018

dënojnë këtë lloj të marrëveshjeve, dhe njëkohësisht kërkojnë edhe pagesë të drejtë të gazetarëve dhe fotoreporterëve, për kontributin e tyre gjatë krijimit të veprave autoriale.

Aktiviteti i fundit në të cilin është fokusuar ky grup pune është Propozimi për Direktivë²⁴ të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për të drejta të autorit në tregun e vetëm digjital, nga 14 shtatori i vitit 2016. Në një tekst të publikuar në korrik të vitit 2018, grupi i punës që përfaqëson më shumë se gjysmë milion gazetarë, shkrimtarë, kompozitorë dhe drejtorë filmash në Evropë, përshëndesin prolongimin që ia bëri Parlamenti Evropian kësaj propozim direktive. Në njoftimin e tyre²⁵ thonë se: *“i bëjmë thirrje Parlamentit Evropian që ta ruajë forcën e tij dhe mbështetjen ndërpartiake për përforcimin e pozicionit të marrëveshjes së autorëve nga Evropa, kjo me qëllim që Direktiva për të drejta të autorit, së shpejti të sjellë përfitime konkrete për të drejtat e autorit në Bashkimin Evropian. Kjo është një mundësi për të ndihmuar në përmirësimin e të drejtave autoriale dhe për të përmirësuar gjendjen sociale dhe ekonomike të gazetarëve gjithandej Evropës”*.

Një prej pjesëve më të rëndësishme të kësaj propozim direktive e cila është e kontestueshme për Federatën Evropiane të gazetarëve, është ajo që nuk jepet një mundësi reale që gazetarët të fitojnë të ashtuquajturën “të drejtë fqinje” për botuesit e mediave. Kjo e drejtë e re nuk i vendos në pozitë të njëjtë gazetarët dhe botuesit, pasi që nuk parashikon pjesë konkrete për kompensim që duhet tu jepet gazetarëve dhe punonjësve mediatik, nga profiti që do të realizohej me publikimin e veprës autoriale nga ana e botuesve.

Përveç kësaj, Federata Evropiane është e shqetësuar për pjesën e direktivës (nen 11), i cili ka të bëjë me riprodhimin e pakontrolluar, dhe mundësinë që prodhimet gazetareske (ose një pjesë e prodhimeve), të transmetohen online, nga persona të tretë, pa leje ose kompensim. Pra, veprat autoriale të gazetarëve me të cilat informohet publiku, është e patjetërsueshme që të njihen si të tilla, dhe të jenë të mbrojtura dhe kompensuara në mënyrë adekuate. Debati për këtë propozim direktivë vazhdon edhe më tej, në kuadër të Parlamentit Evropian, ndërsa Federata Evropiane e gazetarëve dhe grupi i ekspertëve edhe më tej do të vazhdojë të përfaqësojë qëndrimet e gazetarëve, pasi kjo direktivë mund të ndikojë në punën e mëtutjeshme të secilit gazetar në Evropë.

²⁴ Propozim direktiva (2016)593 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian <https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/news/proposal-directive-european-parliament-and-council-copy-right-digital-single-market> qasur më 27.07.2018

²⁵ FEG, 05.07.2018 European Authors call on MEPs to maintain their strong support to authors' rights <http://europeanjournalists.org/blog/2018/07/05/european-authors-call-on-meps-to-maintain-their-strong-support-to-authors-rights/> qasur më 27.07.2018

Një prej arsyeve përse kjo direktivë vazhdon të jetë kontestuese për fushën e gazetarisë, dhe që nuk ishte votuar në Parlamentin Evropian, dhe është e kontestuar edhe nga grupi i ekspertëve për të drejta të autorit në kuadër të FEG, lidhet me nenin 35 për të cilin ky grup ekspertësh kërkon që të ndryshohet. Pra, mbrojtja që u jepet botuesve sipas kësaj direktive, nuk duhet të ndikojë tek të drejtat e autorit dhe bartësve të tjerë të të drejtave, përfshirë edhe nivelin deri tek i cili autorët dhe bartësit e tjetër të të drejtave mund t'i shfrytëzojnë veprat e tyre, pavarësisht se në cilin medium ato janë publikuar.

Prandaj, botuesit nuk duhet të kenë të drejtën që të thirren në mbrojtjen që u jepet kundër autorëve dhe bartësve të tjerë të të drejtave. Autorët, veprat e të cilëve janë publikuar nga ana e botuesve, kanë të drejtë për një pjesë të konsiderueshme të mjeteve financiare shtesë, që botuesit do t'i kishin fituar me ripublikimin ose shfrytëzimin e veprave të tyre.

SISTEMET E ARBITRIMIT DHE VETËRREGULLIMIT QË ZBATOHEN NË MAQEDONI, SI ALTERNATIVË PËR ZGJIDHJEN E RASTEVE NË KËTË FUSHË

Një prej mekanizmave që kontribuojnë në zgjidhjen e shkeljes së të drejtave të autorit të gazetarëve dhe punonjësve mediatik, jashtë procedurave gjyqësore, është principi i vetërregullimit mediatik. Bazament për vetërregullimin e mediave është respektimi i Kodeksit etik të gazetarëve. Sipas Doracakut²⁶ për vetërregullim të OSBE-së, vetërregullimi mediatik është *“përpyetje e përbashkët e profesionistëve mediatik që të zbatojnë rregullativa vullnetare dhe tu përmbahen atyre gjatë procesit të mësimin i cili është i hapur për publikun. Me këtë, mediat e pavarura e pranojnë në tërësi pjesën e tyre të përgjegjësisë për kualitetin e diskursit publik në shtet, njëkohësisht duke ruajtur pavarësinë editoriale gjatë formësimit të diskursit”*.

Në Republikën e Maqedonisë, ekzistojnë dy organizata civile të cilat e promovojnë vetërregullimin, si model i cili mes tjerash, i mbron gazetarët dhe punonjësit mediatik, në kushte kur janë shkelur standardet etike. Kjo duke përfshirë edhe parimin e ndalesës së plagjiaturës. Këto organizata janë, Këshilli i nderit, që është një komision i përbërë nga gazetarë me përvojë në kuadër të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, dhe Komisioni për ankesa në Këshillin e Etikës në

²⁶ Doracak për vetërregullim mediatik i OSBE-së, Vjenë, viti 2008. <https://www.osce.org/fom/31497?download=true>

media, që është i përbërë prej përfaqësuesve të mediave, gazetarëve dhe sektorit civil. Specifikë e të dy trupave është se funksionojnë në bazë të parashtrësive të qytetarëve, për shkelje eventuale të etikës në artikujt gazetaresk, pas çka, komisionet sjellin vendim nëse është shkelur ose jo kodeksi.

Kur Komisioni merr ndonjë vendim, gazetarët, respektivisht mediat që janë anëtare të Këshillit të Etikës, obligohen që të publikojnë ato vendime. Efekti i këtyre mekanizmave është që gazetarët dhe punonjësit e tjerë mediatik joprofesional, të ekspozohen në “murin e turpit”, dhe me këtë, do të shmangeshin procedura gjyqësore kundër tyre. Këto mekanizma janë tejet efikase, por megjithatë, nuk ekzistojnë garanca se edhe pas vendimit të Këshillit, ato do të publikohen tek mediat, dhe kjo nuk garanton se parashtruesi i ankesës tek Këshilli Etik, nuk do të ngrejë padi para gjykatave civile për shkelje të të drejtës së autorit, për shpifje ose ofendim dhe ngjashëm.

Sipas KEMM, gjatë punës katër vjeçare të Komisionit për ankesa, aq sa edhe ekziston kjo organizatë, janë denoncuar edhe raste të shkeljes së të drejtës së autorit. Në këto raste, ankesa ka patur të bëjë vetëm me shkeljen e kësaj të drejte, dhe ndonjëherë, kjo bazë është theksuar edhe me shkelje të tjera të Kodeksit të gazetarëve të Maqedonisë. Për shembull, në punën e Komisionit janë dorëzuar ankesa për “huazim” të fotografive dhe incizimeve, por edhe raste të vjedhjes së tërësishme të teksteve autoriale nga gazetatat dhe transmetimi i tyre në mediat online. Vetëm në fjalinë e parë është theksuar autorësia, por pastaj në vijim të tekstit, është prezantuar si “prodhim” i vetë mediumit online.

Në intervistën e zhvilluar me drejtoreshën e kësaj organizate, d-r. Marina Tuneva, për nevojat e kësaj analize, ajo thotë se në këto raste, para së gjithash, kontaktohet mediumi, me qëllim që të jep qëndrim lidhur me denoncimet në parashtrësë. Nëse vërtetë bëhet fjalë për marrje të pa autorizuar të përmbajtjeve ose materialeve audiovizuale, në këtë rast, prej mediumit pritët që të tregojë gatishmëri që ta zgjidhë problemin me ndërmjetësim. Sipas Tunevës, ekzistojnë forma të ndryshme se si një medium, mund ta “korrigjojë” gabimin, nëpërmjet kërkim faljes, theksimit të qartë të emrit të autorit e të tjerë. Pastaj, përsëri vihet në kontakt me parashtruesin e ankesës, për ta pyetur nëse “korrigjimi” i mediumit, është në pajtueshmëri me pritjet e tij. Por, padyshim që marrja pa leje e përmbajtjeve të tilla paraqet shkelje të Kodit të gazetarëve, në nenin 12.

Sistemi i arbitrimit dhe vetërregullimit, mund të ndihmojë në zgjidhjen e kontesteve, kur shkelet ndonjë e drejtë e autorit, dhe në këtë drejtim Tuneva thotë: *“proces i ndërmjetësimit mund t’u ndihmojë të ashtuquajturave, palë në konflikt, që të tejkalojnë*

kontestin. Vetërregullimi ekziston pikërisht për këtë gjë, që të mos ketë nevojë çdoherë të shkohet në rrugën ligjore. Nuk është më pak e rëndësishme, dhe mund tu ndihmojë gazetarëve dhe punonjësve mediatik që në mënyrë “të pa dhimbshme”, të korrigjojnë gabimet e tyre, sikurse në mbrojtjen e lirisë së shprehjes, por edhe në zvogëlimin ose mënjanimin e ndikimit të qendrave të ndryshme të fuqisë në këtë profesion. Pa dyshim se në këtë profesion bëhen gabime, dhe besoj se do të bëhen gabime edhe më tej, por gjëja më e mirë është kur bartësit e këtij profesioni, do ta kuptojnë gabimin dhe do të parandalojnë që kjo gjë që shkojë në llogari të imazhit dhe integritetit të tyre”.

Përveç kësaj, me iniciativë të një grupi fotoreporterësh, para ca kohësh, në Maqedoni është formuar një platformë online (<http://kolektiv.mk/>), në të cilën publikohen fotografi profesionale të cilat pastaj mund të blihen nga ana e mediave. Kjo paraqet një formë vetërregullimi i cili në të ardhmen, mund të shndërrohet edhe në mekanizëm i cili do t'i mbrojë të drejtat e fotoreporterëve. Në këtë drejtim. Tomislav Georgiev, një fotoreporter, thotë: *“Duke patur parasysh trendin e kalimit të mediave në hapësirën e internetit, kur imperativ është shpejtësia e raportimit, si dhe situata e buxheteve të kufizuara në biznesin mediatik, kemi bërë një platformë interneti ose një agjenci të specializuar për fotografi, nëpërmjet të cilit e mbulojnë të gjithë territorin e shtetit, me fotografi të disperzuara nga qytetet më të mëdha të shtetit, me qëllim të raportimit të shpejtë dhe profesional me një produkt final i cili është i përshtatur me buxhetet e ulëta. Në princip, krijohet një lloj arkiv digjital i fotografive dhe lajmeve, fotografi të cilat krijojnë lajm dhe fotografi gjenerike që janë shkrepur nga fotoreporterë profesional, dhe që mund të shfrytëzohen për ilustrim në lloj lloj edicionesh ose publikimesh”.*

KONKLUZA DHE REKOMANDIME PËR MBROJTJEN E TË DREJTËS SË AUTORIT TË GAZETARËVE, FOTOREPORTERËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK NGA FEDERATA EVROPIANE E GAZETARËVE DHE FEDERATA NDËRKOMBËTARE E GAZETARËVE

Federata Evropiane e gazetarëve (FEG), e formuar në vitin 1994, është organizata më e madhe për nga numri i gazetarëve në Evropë. I përfaqëson më shumë se 320 mijë gazetarë dhe 70 shoqata gazetarësh dhe sindikate, në 44 shtete. FEG promovon edhe mbron të drejtën e lirisë së shprehjes e cila është e garantuar me nenin 10 të Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut. Në kuadër të Federatës, ekzistojnë më shumë grupe pune që janë të përkushtuar në tema të rëndësishme për punën e gazetarëve, dhe njëri prej tyre është grupi i ekspertëve për të drejtat

e autorit (GETA) që është e përbërë nga gazetarë dhe ekspertë juridik. Ky grup pune ka takime të rregullta në të cilat identifikohen rreziqet e mundshme, me qëllim që të mbrohen të drejtat e autorëve, si dhe planifikohen masat për mbrojtje dhe mbështetje të gazetarëve dhe organizatave esnafë të gazetarëve. Një prej qëllimeve të këtij grupit të punës, është që të bëjë aktivitete për ngritjen e vetëdijes së gazetarëve dhe punonjësve mediatik, se si t'i mbrojnë të drejtat autoriale në kuadër të organizatave ku punojnë.

Aktivitetet e FEG, në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të autorit, kërkojnë nga gazetarët dhe punonjësit mediatik që të pranohen si autorë të veprave ose produkteve gazetareske që i krijojnë, respektivisht, edhe më tej të kenë kontroll mbi veprën e tyre autoriale për çka do të merrnin edhe kompensimin e duhur. FEG në këtë drejtim, kundërshton praktikën që përfaqësohet tek sistemi anglo-sakson për të drejtat e autorit sipas të cilit, të gjithë të punësuarit dhe bashkëpunëtorët e jashtëm në një medium, nuk do i kishin të drejtat e njëjta sikurse autorët e përmbajtjeve mediatike në Evropën kontinentale. Përveç kësaj, FEG e përfaqëson edhe qëndrimin për të drejtën e autorit si individ (gazetar, fotoreporter, kolumnist dhe ngjashëm) që të ketë kontroll mbi punën e tij (produktin gazetaresk) pasi kjo është tejet e rëndësishme për standardet etike me të cilat garantohet kualiteti në profesionin e gazetarisë.

FEG më tej në politikat për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe punonjësve mediatik, vlerëson se të njëjtat duhet të kenë mbrojtje të fuqishme juridike të “vlerave morale”, respektivisht se autori duhet të identifikohet si i tillë, dhe e drejta mbi veprën e tij duhet të mbrohet. Një prej zotimeve kryesore të këtij grupi ekspertësh, por edhe të Federatës si organizata më e madhe për nga numri i anëtarëve, është që të përkrahet procesi i harmonizimit të të drejtave autoriale nëpër botë, me qëllim që këto të drejta të ngritën në nivelin e mbrojtjes që ekziston në Evropën kontinentale.

Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve (FNG) është organizata më e madhe gazetareske në botë, e cila për herë të parë është themeluar në Paris, në vitin 1926. Sot, FNG përfaqëson më shumë se 600 mijë anëtarë, në 140 vende të botës. Të drejtat e autorit në kuadër të FNG-së, përpunohen nga një grup ekspertësh, i përbërë nga gazetarë dhe ekspertë juridik të fushës. Grupi i ekspertëve ka takime të rregullta për të detektuar kërcënimet mbi të drejtat e autorit dhe për të bërë plan dhe marrë masa adekuate për mbrojtje dhe mbështetje të gazetarëve dhe shoqatave të tyre të esnafëve, të cilat luftojnë për standarde dhe mbrojtje më të lartë.

Qëndrimi i Federatës ndërkombëtare të gazetarëve me seli në Bruksel, është se edhe gazetarëve duhet t'u respektohen të drejtat e autorit për pronën intelektuale.

FNG sikurse FEG, bën thirrje: *“që gazetarët të pranohen si autorë të produkteve gazetareske të cilat i krijojnë, që të kenë kontroll mbi përdorimin e mëtejme të veprave të tyre, dhe që të mund të marrin kompensimin adekuat për këtë gjë.*

FNG në këtë kontekst, kundërshton sistemin anglo-amerikan për të drejta të autorit, ku gazetarët ose punonjësit mediatik me honorarë, janë të privuar nga këto të drejta.

FNG e mbështet harmonizimin juridik të të drejtave të autorit nëpër botë, me qëllim që të gjithë shtetet, të sillen në nivelin e mbrojtjes që ekziston në Evropën kontinentale. Gjithashtu, FNG insiston që të vendoset edhe menaxhimi kolektiv me të drejtat e autorit, aty ku nuk ekziston.”²⁷

Sipas FNG-së, ekziston praktikë në mes organizatave mediatike me përdorimi e të ashtuquajturave *“marrëveshje për marrjen e të drejtave”, që të shkelen të drejtat e autoriale të gazetarëve. Për shkak të këtij trendi, FNG dhe FEG, kanë nisur fushatë nëpër të gjithë Evropën, kundër marrëveshjeve të tilla, duke insistuar që të ketë një kompensim adekuat dhe të drejtë për gazetarët.”*

REKOMANDIME NGA FNG PËR TË MBROJTUR TË DREJTAT AUTORIALE TË GAZETARËVE

- Gazetarët duhet të informohen për të drejtat e tyre. Të drejtat e autorit janë të mbrojtura me ligje ndërkombëtare dhe ligje vendore. Këto të drejta nuk i përfshijnë vetëm të drejtat ekonomike, materiale (e drejta për të përfutur nga vepra e krijuar) të autorit, por edhe të drejtat morale. Të drejtat morale janë të garantuara me ligjet vendore. Kornizat kombëtare ligjore në më shumë vende evropiane, i pranojnë të drejtat e pandashme morale të autorëve, me përjashtim të Mbretërisë së Bashkuar, Irlandës dhe Holandës, kur të drejtat morale të autorëve mund të kalohen tek dikush tjetër, dhe ku “botuesit” më të shpejti kërkojnë një gjë të tillë. Neni 6b nga Konventa për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike thekson se: *“...autori ka të drejtë që të kërkojë të drejtën e autorit mbi veprën, dhe të kundërshtojë çfarëdo shtrembërimi, korrigjimi ose ndryshim tjetër nënçmues në kontekst të veprës së theksuar, që do ishte e dëmshme për nderin dhe imazhin e tij”.*

²⁷ Federata ndërkombëtare e gazetarëve, artikull për të drejtat e autorit <http://www.ifj.org/issues/authors-rights/> qasur më 28.07.2018

- Thoni JO marrëveshjes së dëmshme me të cilën hiqni dorë nga të drejtat e juaja, zotohuni për marrëveshje kolektive, dhe menaxhim kolektiv. Gazetarët të cilët nënshkruajnë kësi lloj marrëveshjesh, jo vetëm që humbin të drejtën për të menaxhuar me veprën e tyre në mënyrë autonome, por e humbin edhe të drejtën morale për të mbrojtur integritetin e veprave të tyre. FEG dhe FNG i inkurajojnë shoqatat e esnafëve dhe sindikatat, që të zotohen për marrëveshje kolektive ose menaxhim, ose për model të marrëveshjeve në të cilat është e vendosur edhe një klauzolë për të drejtat e autori. Në një klauzolë të tillë do shkruante se :
 1. *Të gjithë të drejtat e autorit nga vepra, mbeten tek autorët, të cilët do t'i gëzojnë të drejtat ekskluzive. Leja e dhënë për publikim ose emetim të veprës, do jetë e kufizuar vetëm në publikimin e parë. Përveç nëse nuk ekziston ndonjë marrëveshje eksplicite me shkrim për të kundërtën, leja do të skadojë në një afat të caktuar, siç është lejuar me ligjin kombëtar, pas datës së dorëzimit. Botuesi ose radiodifuzeri, nuk do të bëjë kopje pa lejen e autorit, pasi t'i ketë skaduar leja,*
 2. Çfarëdo lloj modifikimi i veprës, do duhet të jetë bërë me miratim të mëparshëm të autorit,
 3. *Botuesi / radiodifuzeri pajtohet se titulli në vazhdim (emri i autorit, data) do duhet të qëndrojë në secilin publikim ose emetim të këtij materiali.²⁸*

Çfarë paraqet e ashtuquajtura marrëveshje për “rrëmbimin ose marrjen e të drejtave” (right grabbing contracts)?

Në kundërshtim me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare, marrëveshjet për “rrëmbimin ose marrjen e të drejtave” shpesh herë u diktojnë gazetarëve që të heqin dorë nga të drejtat e tyre autoriale, përfshirë këtu edhe të drejtat ekonomike dhe morale.

Këto marrëveshje u kërkojnë gazetarëve që:

- *t’ia kalojë botuesit të drejtën botërore, ekskluzive, për të përdorur, riprodhuar, emetuar, ndryshuar dhe distribuuar veprën gazetareske, në të gjithë platformat e ndryshme, të njohura ose të ardhshme dhe*

²⁸ Marrëveshje fer për gazetarët, FNG <http://www.ifj.org/campaigns/fair-contracts-for-journalists/> qasur më 28.07.2018

- *t'i lejojë botuesit që t'i kalojë të drejtat autoriale tek persona të tretë, pa kompensim shtesë për autorin, dhe ti shfrytëzojë veprat në mënyrën që botuesi do të vlerësojë se është e nevojshme..*

REFORMAT PRIORITARE TË QEVERISË SË RM-SË, NË KONTEKST TË NDRYSHIMIT DHE PLOTËSIMIT TË LIGJIT PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA

Për nevojat e kësaj analize, në korrik të vitit 2018, është bërë kontakt me Ministrinë e Kulturës së Republikës së Maqedonisë, prej ku janë marrë informacione për reformat më të rëndësishme prioritare të Qeverisë, në drejtim të ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, respektivisht, fazën e ndryshimeve dhe plotësimeve, analizat komparative me legjislativin rajonal dhe direktivat, rekomandimet evropiane.

Në planin strategjik²⁹ të Ministrisë së Kulturës, për periudhën 2018-2020, që përfshin programe dhe nën programe për pjesën më të madhe të reformave në fushën e kulturës në Maqedoni, është theksuar se *"me qëllim të mbrojtjes efikase dhe realizimit efektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, jepet mbështetje për potencialin e veprimtarive dhe industrive kulturore, duke u bazuar në shfrytëzimin e veprave autoriale dhe të drejtave të përafërta që burojnë nga shfrytëzimi i tyre, si dhe për sensibilizimin e publikut për trajtimin adekuat të të drejtës së autorit në qarkullimin ligjor"*

Në bazë të Plani strategjik , një prej prioriteteve të Ministrisë së Kulturës është e drejta autoriale dhe të drejtat e përafërta. *"Qëllimi strategjik është që të krijohet një aktivitet i fortë vendor dhe ndërkombëtar në fushën e kulturës, me qëllim të përafrimit të vlerave kulturore evropiane deri tek qytetarët e Maqedonisë, për zbatimin e rekomandimeve nga Bashkimi Evropian në kulturë, sidomos në kontekst të mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta. Qëllimi kryesor është të zbatohet një sistem për realizimin efikas të të drejtave autoriale dhe të drejtave të përafërta, përfshirë edhe menaxhimin kolektiv me të drejtën autoriale, si pjesë e nisjes së bisedimeve me Bashkimin Evropian".*

²⁹ Plan strategjik i Ministrisë së Kulturës, viti 2018-2020, <http://www.kultura.gov.mk/index.php/odnosi-so-javnost/soopstenija/3480-----2018-2020->

Me qëllim që të sillen ndryshime dhe plotësime të ligjit që do të harmonizohen me legjislativin e Bashkimit Evropian, me çka do të krijoheshin kushte për realizim të papenguar të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, e sidomos në pjesën e menaxhimit kolektiv, ministria ka konstatuar nevojën nga *"një analizë transparente e Propozim ligjit, me respektim të qëndrimeve të të gjithë palëve (bartësve të të drejtave)* në procesin e sjelljes së ndryshimeve *ligjore"*.

Ministria e Kulturës, në mars të vitit 2018, ka përgatitur një analizë komparative për legjislativin vendor, dhe praktikën e vendeve të rajonit dhe BE-së, lidhur me realizimin kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave kolektive. Kjo analizë përmban çështje të procedurës për ndarje të lejeve për organizatat për menaxhim kolektiv, mënyrën e monitorimit të shfrytëzimit të veprave autoriale, dhe përkufizimit të kompensimeve të autorëve për pronësi intelektuale. Sipas Ministrisë së Kulturës, analiza së bashku me tekstin e ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjit, është dorëzuar për mendim deri tek bartësit e të drejtave dhe përdoruesve të tyre.

REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E KORNIZËS LIGJORE ME QËLLIM TË MBROJTJES MË TË MADHE TË TË DREJTAVE AUTORIALE TË GAZETARËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK

- » Ndryshim të nenit 86 nga Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtave të përafërta, me çka do të garantohet se të drejtat materiale për veprën e krijuar gjatë marrëdhënies së punës, duke kryer detyrat e punës, të drejtat e kësaj vepre do t'i përkasin ekskluzivisht vetëm autorit, përveç nëse gjatë marrëveshjes për punësim, palët nuk janë marrë vesh ndryshe. Ky rekomandim duhet të implementohet në Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, në mënyrën siç është e rregulluar në nenin 76 nga ligji kroat, dhe në pajtueshmëri me politikën e Federatës ndërkombëtare dhe evropiane me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve të tjerë mediatik.
- » Harmonizimi i Ligjit vendor me *"Direktivën 2014/26/EC për menaxhim kolektiv me të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta, dhe licencimi multiterritorial i veprave muzikore për shfrytëzim në internet"* me çka mundësohet menaxhimi multiterritorial dhe realizimi i drejtave të autorit në mënyrë. Kështu, në rast të shkeljes së të drejtave të gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve mediatik,

që mund tu vidhen veprat e tyre jashtë Maqedonisë, ata mund të kërkojnë mbrojtje nëpërmjet organizatave për menaxhim kolektiv jashtë Maqedonisë,

- » Të shqyrtohet mundësia për formimin e një shoqate jofitimprurëse që do të merret me menaxhimin kolektiv të të drejtave të autorit për gazetarët, fotoreporterët dhe punonjësit mediatik, me leje nga institucioni kompetent, në pajtueshmëri me praktikën e Republikës së Kroacisë,
- » Gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve mediatik tu mundësohet një mbrojtje më efikase juridike dhe gjyqësore, në pajtueshmëri me mundësitë e tyre ekonomike, kur u janë cenuar të drejtat autoriale dhe morale, nëpërmjet ndihmës juridike pa pagesë nga shoqatat esnafe,
- » Të organizohen fushata publike për ngritjen e vetëdijes dhe informimit të gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve mediatik për të drejtat e tyre, por edhe për respektimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, gjatë përpilimit të përmbajtjes gazetareske, pa u kufizuar e drejta e lirisë së shprehjes, kjo duke ndjekur shembullin e Federatës Evropiane të gazetarëve me fushatën e tyre “Marrëveshje të drejta për të gjithë gazetarët”³⁰,
- » Të mundësohet edukimi i vazhdueshëm i gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve mediatik nga ana e organizatave esnafe, pavarësisht se a janë në marrëdhënie të rregullt pune në shtëpi mediatike, ose punojnë me honorar, se si të mbrohen nga marrëveshjet e dëmshme të punësimit, me të cilat u merren të drejtat e autorit, ose i kalohen punëdhënësit,
- » Sindikata e gazetarëve të promovojë marrëveshje punësimi dhe marrëveshje kolektive nëpërmjet të cilave do të mbroheshin të drejtat materiale të gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve mediatik, dhe ku për shfrytëzimin e një përmbajtjeje mediatike, ata do të marrin kompensimin e duhur nga ana e mediumit,
- » Organizatat esnafë të promovojnë mekanizma vetërreguluese gjatë zgjidhjes së kontesteve nga fusha e autorësisë mes gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve mediatik si alternativë për proceset gjyqësore,
- » Të zbatohen trajnime të patjetërsueshme nga ana e gjykatësve nga gjykatat civile në Maqedoni, dhe Akademia e gjykatësve dhe prokurorëve, për shkelje të të drejtave të autorit të gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve mediatik, në pajtueshmëri me praktikën pozitive të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut.

³⁰ Artikull për fushatën që e zbaton FNG-ja, publikuar në ueb faqen e tyre <https://europeanjournalists.org/fair-contracts-for-journalists/> qasur më 18.07.2018

LISTA E SHKURTESAVE

ESHPIRK - Enti shtetëror për pronësi intelektuale në Republikën e Kroacisë

RINER - Regjistri i vetëm nacional elektronik për rregullativa

GETA - Grupi i ekspertëve për të drejta të autorit

FEG - Federata Evropiane e gazetarëve

LSHAAV - Ligji për shërbime audio dhe audiovizuale

LTATP - Ligji për të drejta të autorit dhe të drejta të përafërta

SHGM - Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë

LMO - Ligji për marrëdhënie obliguese

KP - Kodi Penal

SHMTA - Shoqata për mbrojtjen e të drejtave autoriale të gazetarëve

FNG - Federata ndërkombëtare e gazetarëve

OSBE - Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë

GJETN - Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut

SHBA - Shtetet e bashkuara të Amerikës

KEMM - Këshilli për Etikë në media të Maqedonisë

OBPI - Organizata botërore për pronësi intelektuale

Marrëveshja TRIPS - Marrëveshja për aspektet tregëtare të pronësisë intelektuale

DUTN - Deklarata universale për të drejtat e njeriut

KUTA - Konventa universale për të drejta të autorit

UNESCO - Organizatë e Kombeve të Bashkuara për arsim, shkencë dhe kulturë

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

347.78:340.13]:316.774-051(497.7)

347.78:347.95]:316.774-051(497.7)

347.78:341.24]:316.774-051

347.78:341.645]:316.774-051

347.78:316.774-051]:061.2

BRESHKOVSKI, Ivan

Ndikimi i ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e
përafërta në punën e gazetarëve, fotoreporterëve dhe punëtorëve mediatik
: praktika dhe rekomandime / [autorë Ivan Breshkovski Igor Markovski]. -
Shkup : Fondacioni Konrad Adenauer, 2018. - 44 стр. : илустр. ; 24 см

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4648-37-6

1. Markovski, Igor [автор]

а) Авторски права - Медиуми - Законодавство и судска пракса -
Македонија

б) Авторски права - Медиуми - Меѓународна регулатива и судска пракса в)
Авторски права - Медиуми - Граѓански организации

COBISS.MK-ID 108377866